

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6878
E hënë, 24 prill 2023
Çmimi 0.40

Ukraina vendos sanksione ndaj kompanive që ndihmojnë ushtrinë ruse **FAQE 2**



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PJESËMARRJE E ULËT NË ZGJEDHJE NË KATËR KOMUNAT NË VERI. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE NË KOSOVË (KQZ) PUBLIKON REZULTATET PRELIMINARE **FAQE 4-5**

LV-ja DHE PDK-ja FITOJNË NGA DY KOMUNA NË VERI, LISTA SERBE NUK I PRANON ZGJEDHJET



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë (KQZ) ka bërë me dije se 1 567 qytetarë nga mbi 45 000 sa kishin të drejtë vote, dolën të dielën në zgjedhjet lokale të parakohshme në veri të Kosovës:

Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq. Sipas të dhënave të KQZ-së, në Mitrovicë të Veriut dhe në Leposaviq fituan kandidatët e Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa në Zubin

Potok dhe Zvečan ata të Partisë Demokratike të Kosovës. Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, nuk garoi në zgjedhje dhe bëri thirrje për bojkotim të tyre

AKTUALE



DODIKU PARALAJMËRON SHKËPUTJEN E REPUBLIKËS SËRPSKA DHE BASHKIMIN ME SERBINË **F. 2**

SHBA-ja EVAKUON STAFIN DIPLOMATIK NGA SUDANI **F. 2**

SHËNOHET DITA BOTËRORE E LIBRIT **F. 6**

EKONOMI



PËR DY VJET KOSOVA HUMBET DY INVESTITORE STRATEGJIKË **F. 8**

SPORT



BALLKANI RUAN KREUN, DRITA FITON NDAJ PRISHTINËS **F. 10**

TREPÇA BARAZON SERINË GJYSMËFINALE NDAJ PRISHTINËS, PEJA KUALIFIKOHET NË FINALE **F. 10**

PSE SBASHK-U PO E KUNDËRSHTON TESTIMIN E MËSIMDHËNËSVE?



HARADINAJ: MOBILIZIM GJITHANDEJ NË DIASPORË PËR PËRKRAHJE TË AAK-së



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ShBA-ja evakuon stafin diplomatik nga Sudani

Uashington, 23 prill - Ushtria amerikane ka evakuuar diplomatët amerikanë dhe familjet e tyre nga kryeqyteti i Sudanit, Kartum, tha presidenti i ShBA-së, Joe Biden. "Me urdhrin tim, ushtria e Shteteve të Bashkuara kreu një operacion për nxjerrjen e personelit të Qeverisë amerikane nga Kartumi", tha përmes një deklaratë Biden.

Një zyrtar tjetër amerikan tha se operacioni ishte "i shpejtë dhe i pastër".

Ministria e Jashtme e Francës njoftoi po ashtu se ka nisur evakuimin e qytetarëve të saj dhe të stafit diplomatik nga Sudani. Mbretëria e Bashkuar tha se po shqyrton mënyra për të

evakuuar stafin e saj, ndërsa Qeveria kanadeze u kërkoi qytetarëve të saj atje që "të strehohen në vende të sigurta".

Dhuna në Kartum ka nisur javën e kaluar midis dy ushtrive rivale, gjegjësisht ushtrisë së rregullt dhe asaj që njihet si Forcat e Mbështetjes së Shpejtë.

Dy gjeneralët e tyre udhëheqin Sudanin nga viti 2021, kur përmes një grushtshteti kanë rrëzuar Qeverinë civile të vendit. Mosmarrëveshjet e tyre tani kanë të bëjnë me transferimin e pushtetit tek një autoritet civil dhe me integrimin e Forcave të Mbështetjes së Shpejtë në ushtri. Qindra njerëz janë vrarë në luftime dhe mijëra të tjerë janë larguar nga shtëpitë.



Dodik paralajmëron shkëputjen e Republikës Sërpska dhe bashkimin me Serbinë

SARAJEVË, 23 PRILL - Presidenti i Republikës Sërpska, Millorad D odik, foli më 23 prill në ngjarjen për të shënuar Ditën e Përkujtimit të 700 000 viktimave të krimeve të ushtarëve në kampin e përqendrimit të Jasenovacit, ngjarje që u mbajt në Donja Gradina.

Ai foli për këto krime, i krahasoi ato me krimet e luftës së fundit në territorin e Jugosllavisë së atëhershme dhe foli për shkëputjen e Republikës Sërpska dhe bashkimin me Serbinë. "Ne jemi këtu nga Republika Sërpska sepse i takojmë një kombi dhe një ditë ne do të jemi një shtet. Askush nuk do të na ndalojë që ta bëjmë këtë sepse është e drejta jonë dhe historia jonë. Shekulli i kaluar ishte shekulli i vuajtjes serbe dhe ky shekull do të jetë shekulli i bashkimit të serbëve", tha Dodik, duke shtuar se shteti është fjalë kyçe në lirinë e tyre.



"Prandaj ne duam që qartazi ta themi se nuk ka iluzione apo kërcënime për këdo kur Republika Sërpska shpreh vullnetin e saj popullor për të formuar shtetin e vet, sepse ne nuk mund të jetojmë në Bosnjë e Hercegovinë, shtet që na shtyp ne dhe kërcënon liritë tona", tha Dodik para të pranishmëve.

Ai vlerësoi se serbët "nuk mund të mbijetojnë në këto zona, nëse Republika Sërpska nuk bëhet e pavarur në vitet në vijim". "Ne do ta bëjmë Republikën Sërpska një shtet në paqe, pa konflikte dhe luftëra. Ne nuk mund të jetojmë në Bosnjë e Hercegovinë", tha Dodik, duke shtuar se nuk ka asgjë kundër boshnjakëve dhe

kroatëve.

Dodik po ashtu tha se serbët ishin viktimat më të mëdha të shekullit të kaluar, fillimisht të Luftës së Parë Botërore, por edhe të luftërave që shpërthyen gjatë shpërbërjes së Jugosllavisë.

Ai bëri një sërë akuzash ndaj përfaqësuesve ndërkombëtarë në Bosnje, të cilët ai i quajti "fundërrina", duke theksuar se ata dëshirojnë të marrin pronat nga serbët në Republikën Sërpska.

Dodik tha se përfaqësuesit ndërkombëtarë dhe diplomatët nga shtetet perëndimore "barazojnë krimin në Srebrenicë me vuajtjet në Jasenovac, sepse nuk janë të njëjta". "Ju që jeni nga Amerika dhe Evropa kurrë nuk keni thënë se këtu është kryer gjenocid kundër serbëve, por ju jeni të gatshëm të përdorni gjithçka që keni, nga bombat NATO-s, për të justifikuar

veprimet që keni kryer në vitet '90, duke punuar në shpërbërjen e Jugosllavisë", tha Dodik.

Lideri i serbëve të Bosnjës përsëriti se në Srebrenicë nuk është kryer gjenocid, por tha se atje ka ndodhur krim për të cilin janë përgjegjës individë.

Dodik u bëri thirrje përfaqësuesve të shteteve perëndimore që të pranojnë qëndrimin se serbët nga Republika Sërpska "nuk mund të jetojnë në Bosnjë e Hercegovinë", sepse, siç tha ai, "koncepti i shtetësisë në Bosnje është një projekt anti-serb, që synon të eliminojë popullsinë serbe nga këto zona".

Ai shtoi se komuniteti ndërkombëtar mund të dërgojë sa të dojë njësi ushtarake në Bosnje, por kjo, sipas tij, nuk do t'i ndalojë serbët që të luftojnë për shtetin e ashtuquajtur Republikë Sërpska.

Ukraina vendos sanksione ndaj kompanive që ndihmojnë ushtrinë ruse

KIEV, 23 PRILL - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelenskyy ka njoftuar për sanksione të reja për qindra kompani që, sipas tij, kanë mbështetur agresionin rus.

Zelenskyy tha se 322 kompani, që prodhojnë pajisje ushtarake për ushtrinë ruse, si armë dhe pajisje të tjera, janë vënë në listën e kompanive ndaj të cilave Ukraina ka vendosur sanksione.

Ndërkohë luftime të ashpra

vazhdojnë në territorin e qytetit Bakhmut mes forcave ukrainase dhe trupave ruse. Ministria e mbrojtjes së Rusisë tha se trupat e saj kishin zgjeruar kontrollin në qytet.

Beteja në Bakhmut është një nga më të ashprat që prej nisjes së luftimeve 14 muaj më parë në Ukrainë. Qyteti në lindje të Ukrainës është pothuajse i shkatërruar nga luftimet brenda tij dhe sulmet me bomba.



Pse SBASHK-u po e kundërshton testimin e mësimitdhënësve?



PRISHTINË, 23 PRILL - Mësuesja A. D. nga Podujeva tha se është kundër testimit me shkrim për njohuritë e mësimitdhënësve, pasi një proces të tillë e konsideron nënçmues për vetë ata dhe veprim që vë në dyshim nivelin e mësuesve, arsimtarëve dhe profesorëve. Ajo tha për "Radion Evropa e Lirë" se një testim i tillë do të kishte ndikim negativ të mësimitdhënësit, duke argumentuar se do të ndiheshin të pavlerë dhe të padobishëm për institucionet arsimore ku punojnë.

A. D., që nuk deshi t'i publikohej emri i plotë, tha se ajo personalisht nuk do të pranonte që të testohet me shkrim lidhur me njohuritë e saj për fushat që ajo jep mësim. "Jo asnjëherë [nuk do të pranoja testin me shkrim]... Një mësimitdhënës deri te ditari ka kryer mjaftueshëm teste... Mendoj që është nënçmim të rritetosh një mësimitdhënës pas përfundimit të një niveli arsimor", tha kjo mësuese. Edhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-u) vazhdimisht ka deklaruar se nuk do të pranojë që mësimitdhënësit t'u nënshtrohen testeve për njohuritë, pasi e kanë vlerësuar si të panevojshëm, madje ofendues nëse miratohet një testim i tillë me shkrim. Sipas kreut të SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, nëse miratohet një testim i tillë, atëherë do të vihej në dyshim edhe përgatitja universitare dhe kualifikimet e tjera të mësimitdhënësve të Kosovës. "Ne nuk ndryshojmë qëndrim dhe nganjëherë po përzihen dy terme, testim i njohurive me shkrim dhe

vlerësim i performancës së mësimitdhënësve. Ne ishim, jemi dhe mbetemi kundër testimit me shkrim të njohurive të mësimitdhënësve, ngase është nënçmues dhe degradues dhe e vë në pikëpyetje, pa asnjë arsye, dijen që ata e kanë marrë në universitetet e Kosovës. Madje edhe vë në pikëpyetje, pa arsye, edhe punën që e kanë bërë profesorët e nderuar me këta studentë që i kanë përgatitur për sektorin e arsimit", tha Jasharaj për "Radion Evropa e Lirë".

Debati se a duhet të testohen njohuritë dhe performanca e mësimitdhënësve, që aktualisht janë ende të punësuar, duket se ende vazhdon, pasi së fundmi është përmendur një draft-udhëzim administrativ për licencimin e mësimitdhënësve në kuadër të pakos së ndryshimeve legjislativë.

Mësimitdhënësit, të cilët dëshirojnë të gradohen me licenca të avancuara, të përhershme dhe të karrierës, do të duhej t'u nënshtrohen disa vlerësimeve, të cilat do të përcaktohenin pasi të hynte në fuqi udhëzimi administrativ për licencimin e mësimitdhënësve. Në një përgjigje të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) për "Radio Kosovën" u tha se rast se mësimitdhënësi i cili kalon nga licenca e karrierës në atë të avancuar, parashihet edhe një shtesë në page për të.

Lidhur me këtë, kreu i SBASHK-ut, Jasharaj, tha se nuk është kundër draft-udhëzimit të MASHTI-t, sepse mësimitdhënësve u ofrohet mundësia që t'i nënshtrohen testimit vullnetarisht dhe se ata

vazhdimisht kanë kërkuar që inspektorët profesionalë të shohin nga afër angazhimin e çdo mësimitdhënësi që ka në klasë me nxënësit. "Është përgatitur gati në tërësi dhe i mbetet në fund ministres [së Arsimit] Arbërie Nagavci, pra ministrja ta nënshkruajë dhe pastaj të fillojë edhe procedura e gradimit. Ajo se çfarë duhet të dinë mësimitdhënësit e Kosovës është që do të jetë çështje në mënyrë vullnetare, pra [për ata] mësimitdhënës të Kosovës që e ndjejnë veten të përgatitur", theksoi Jasharaj. REL-i ka tentuar ta kontaktojë MASHTI-n lidhur me testimin me shkrim për njohuritë e mësimitdhënësve, për të kuptuar se cili është qëllimi dhe kur mendohet të realizohet, mirëpo nga ky institucion nuk ka marrë përgjigje deri në publikimin e këtij teksti.

Sipas udhëzimit administrativ për sistemin e licencimit dhe zhvillimit të mësimitdhënësve në karrierë, sistemi i vlerësimit të performancës së mësimitdhënësve përbëhet nga vlerësimi i brendshëm i performancës së mësimitdhënësit, vetëvlerësimi dhe vlerësimi nga shkolla i udhëhequr nga drejtori dhe vlerësimi i jashtëm i performancës i udhëhequr nga Inspektorati i Arsimit.

Për mundësin e testit me shkrim të njohurive të mësimitdhënësve, sociologia Flakë Ymeri tha për REL-in se nuk është i nevojshëm, për arsye se përveç se, sipas saj, është përbuzës, mund të ketë pasoja në shoqëri varësisht nga rezultati i atyre testeve nëse zbatohet. "Unë uroj që të mos aprovohet një kërkesë e tillë sepse mund të zgjojë një

luhatje të nxënësit dhe të të gjithë popullata, dhe të vihet në lajthitje dijenia dhe gjitha ato diploma", tha Ymeri, duke shtuar se në aspektin shoqëror, përveç që do të jetë një thyerje emocionale dhe ulje e motivit të mësimitdhënësit, sigurisht edhe një përbuzje për ta. "Edhe nxënësit do t'i shohin ndoshta me një sy tjetër... Krijon një lloj kaosi, pastaj mund të ketë edhe revolta që mund të jenë të arsyeshme nga ana e mësimitdhënësve dhe me këtë çështje ne vetëm kontribuojmë në aspektin negativ", shtoi ajo. Në pyetjen se kush është nismëtari i testimit me shkrim për njohuritë e mësimitdhënësve, Jasharaj nga SBASHK-u tha se vetë ish-zëvendësministri i Arsimit, Dukagjin Popovci, ka deklaruar se një testim i tillë nuk ka qenë ide e MASHT-it. "Kërkesën me test me shkrim nuk e ka iniciuar askush, por është përmendur edhe në kohët e kaluara nga

ministrat e tjerë në momente të caktuara, si ide të cilën e kemi kundërshtuar arsyeshëm dhe po them as Nagavci e as Popovci, sa ishte zëvendësministër, nuk e kanë përmendur drejtpërdrejt... dhe ne jemi dakorduar dhe MASHT-i ka thënë në atë kohë se testi me shkrim nuk është as në planin e tyre", u shpreh Jasharaj. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), në vitin shkollor 2021/22 në Kosovë ishin 611 mësimitdhënës për nivelin parashkollor, 17.211 mësimitdhënës për nivelin parafillor, fillor dhe të mesëm të ultë, si dhe 5.211 mësimitdhënës të arsimit të lartë.

Cilësia e arsimit në sistemin parauniversitar të Kosovës është kritikuar shpesh nga institucionet ndërkombëtare. Në dy testet e programit ndërkombëtar për vlerësimin e nxënësve, PISA, Kosova ka dalë gati në fund të ranglistës botërore.

Si kualifikohen dhe licencohen mësimitdhënësit në Kosovë?

Në udhëzimin administrativ të sistemit të licencimit dhe zhvillimit të mësimitdhënësve në karrierë thuhet se sistemi i licencimit zbatohet me atë të zhvillimit në karrierë. Po në këtë udhëzim shpjegohet se zhvillimi dhe kualifikimi realizohet në bazë të Ligjit për Arsimin e Lartë, programeve të akredituara dhe politika të tjera arsimore që rregullojnë këtë aspekt. Sistemi i licencimit përcakton katër lloje të licencës së rregullt: licencë për mësimitdhënës të karrierës, licencë për mësimitdhënës të avancuar, licencë për mësimitdhënës mentorë dhe licencë për mësimitdhënës të merituar.



PJESËMARRJE E ULËT NË ZGJEDHJET NË KATËR KOMUNAT NË VERI. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE NË KOSOVË (KQZ) PUBLIKON REZULTATET PRELIMINARE

LV-ja dhe PDK-ja fitojnë nga dy komuna në veri, Lista Serbe nuk i pranon zgjedhjet

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në Kosovë (KQZ) ka bërë me dije se 1 567 qytetarë nga mbi 45 000 sa kishin të drejtë vote dolën të dielën në zgjedhjet lokale të parakohshme në veri të Kosovës: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zvečan dhe Leposaviq. Sipas të dhënave të KQZ-së, në Mitrovicë të Veriut dhe në Leposaviq fituan kandidatët e Lëvizjes Vetëvendosje, ndërsa në Zubin Potok dhe Zvečan ata të Partisë Demokratike të Kosovës. Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, nuk garoi në zgjedhje dhe bëri thirrje për bojkotim të tyre

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 PRILL - Të dielën janë mbajtur zgjedhjet në katër komuna në veri të Kosovës, në Mitrovicë të Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok. Në këto zgjedhje votuan 1 567 qytetarë apo 3.47 për qind e trupit votues. Ata votuan për të zgjedhur katër kryetarë të rinj në Mitrovicë të Veriut, Zvečan, Leposaviq dhe Zubin Potok dhe dy përbërje të reja të asambleve komunale në Leposaviq dhe Zvečan.

Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, nuk garoi në zgjedhje dhe bëri thirrje për

bojkotim të tyre. Thirrje të ngjashme bëri edhe Beogradi zyrtar.

Kreu i KQZ-së, Kreshnik Radoniqi, ka bërë me dije se procesi është zhvilluar pa asnjë problem. Sipas rezultateve preliminare, Lulzim Hetemi nga Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 73.5 për qind të votave në Leposaviq, apo 100 vota gjithsej.

Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje në Mitrovicë të Veriut, Erden Atiq, fitoi 66.5 për qind të votave, apo 519 vota gjithsej.

Në Zubin Potok, Izmir Zeqiri nga Partia Demokratike e Kosovës mori 52.1 për qind të

votave, apo 196 vota. Ndërkaq, në Zvečan, Ilir Peci nga Partia Demokratike e Kosovës fitoi 60 për qind të votave apo 114 vota.

Kandidatja e pavarur në këtë komunë, Sllagjana Pantoviq, që ishte kandidatja e vetme serbe, fitoi pesë vota, apo 2.6 për qind.

Në këto rezultate nuk janë të përfshirë votat me kusht.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vendosi kontejnerë nëpër rrugët kryesore në veri, që shërbyen si qendra votimi. Në garë ishin dhjetë kandidatë, prej të cilëve vetëm një nga komuniteti serb.

Komunat në veri mbetën pa kryetarë nga nëntori i vitit të kaluar, kur përfaqësuesit serbë në atë zonë dhanë dorëheqje nga vendet e tyre të punës për shkak të mospajtimin me një vendim të Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e makinave me targa ilegale serbe.

Nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoiçi, tha se populli serb në Kosovë “nuk do të lejojë kurrë” që komunat me shumicë serbe në veri të vendit të udhëhiqen nga ata që kanë fituar “1 apo 2 për qind të votave” në zgjedhje.

Ai nuk saktësoi se çfarë masash

mund të ndërmerren.

Përmes një deklarate të shpërndarë për mediet, Radoiçi tha se beson se “të gjithë e kanë kuptuar mesazhin që dha populli serb nga veriu i Kosovës”, i cili e bojkotoi në masë të madhe procesin zgjedhor.

Radoiçi tha se i falënderon bashkatdhetarët e tij nga Leposaviqi, Zveçani, Mitrovica e Veriut dhe Zubin Potoku për “patriotizmin, dinjitetin, nderin dhe unitetin e dëshmuar”. “Është në dorën tonë që së bashku me vendin tonë, Serbinë, dhe me presidentin Aleksandër Vuçiq ta vazhdojmë luftën për të ruajtur paqen dhe të drejtën e serbëve për të jetuar jetën e tyre”, tha Radoiçi.

Drejtori i Zyrës për Kosovën të Qeverisë së Serbisë, Petar Petkoviç, tha më 23 prill se fitues i zgjedhjeve në veri të Kosovës është “populli serb në Kosovë, i cili i bojkotoi këto zgjedhje sepse nuk dëshiroi okupimin”. “Kjo është një disfatë për atë pjesë të bashkësisë ndërkombëtare që e mbështeti [kryeministrin e Kosovës, Albin] Kurtin dhe deklaroi se do t'i njohë rezultatet” e zgjedhjeve, tha

Petkoviçi në konferencën për medie të mbajtur në Beograd. Petkoviçi tha se, sipas të dhënave të autoriteteve në Serbi, në zgjedhje kanë votuar 13 persona të kombësisë serbe. Ai i quajti zgjedhjet “antidemokratike dhe jolegitime”. Petkoviçi e kritikoi Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) që lejoi mbajtjen e zgjedhjeve në kontejnerë që ruhen nga Policia e Kosovës. Ai, po ashtu, tha se “nuk ka rrugë të mëtutjeshme drejt normalizimit të marrëdhënieve” në mes të Kosovës dhe Serbisë pa u themeluar Asociacioni i Komunave me Shumicë Serbe. Beogradi zyrtar, i cili mbështet Listën Serbe, ka bërë thirrje për bojkotimin e zgjedhjeve.

Serbia dhe serbët në Kosovë kërkojnë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, për të cilin Prishtina dhe Beogradi kanë rënë dakord dhjetë vjet më parë, përpara se të marrin pjesë në ndonjë votim.

BE-ja dhe ShBA-ja kanë thënë javën e kaluar se janë të zhgënjyera me faktin që serbët kanë vendosur të mos marrin pjesë në zgjedhje.

Prokuroria: Asnjë rast penal gjatë zgjedhjeve në veri

Prokuroria e Shtetit tha se gjatë votimeve për zgjedhjet lokale në veri të Kosovës nuk është evidentuar ndonjë rast për vepra penale kundër të drejtave të votimit.

“Prokurori i Shtetit do të vazhdojë ta mbikëqyrë procesin e numërimit të votave deri në përfundimin e këtij procesi”, u tha në njoftim.

DnV: Zgjedhjet kaluan pa asnjë incident

Organizata Demokracia në Veprim (DnV) tha se refuzimi i partive serbe dhe tërheqja e kandidatëve nga gara zgjedhore bëri që zgjedhjet e parakohshme lokale në katër komunat në veri të Kosovës të bojkotoheshin nga votuesit serbë.

DnV ka vëzhguar zgjedhjet lokale të mbajtura të dielën në Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok.

Përveç zgjedhjes së kryetarëve të rinj, qytetarët në këto

komuna, të banuara me shumicë serbe, votuan edhe për përbërjet e reja të asambleve komunale në Leposaviq dhe Zveçan. “Sa i përket administrimit të zgjedhjeve, është vërejtur një improvizim i procesit zgjedhor, duke nisur nga zhvillimi i zgjedhjeve në kontejnerë, që kanë zëvendësuar rreth 70 për qind të qendrave të zakonshme të votimit”, tha DnV.

ShBA-ja: Keqardhje për mospjesëmarrjen e partive serbe në zgjedhje

Shtetet e Bashkuara sërish shprehën keqardhje që partitë serbe nuk morën pjesë në zgjedhjet lokale në veri të Kosovës që u mbajtën më 23 prill. “Ne përkrahim një demokraci të larmishme, gjithëpërfshirëse dhe shumetnike në Kosovë dhe zgjedhjet që e mbështesin atë. Është për të ardhur keq që jo të gjitha partitë shfrytëzuan të drejtën e tyre demokratike për të marrë pjesë në zgjedhjet e sotme. Pjesëmarrja në zgjedhje ndihmon për t’u siguruar që udhëheqësit janë përfaqësues

të popullatës që iu shërbejnë. Votimi është një liri e rëndësishme e shoqërive demokratike”, u tha në njoftimin e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.

Ambasadori francez: Zgjedhjet me këtë numër votuesish nuk sjellin zgjidhje politike

Ambasadori i Francës në Kosovë, Olivier Guerot, ka deklaruar se zgjedhjet lokale me pak votues në Veriun e Kosovës nuk sjellin zgjidhje politike. Ai ka shprehur keqardhje për mungesën e pjesëmarrjes së disa partive politike, por ka thënë se pikë pozitive ishte profesionalizmi i Policisë së Kosovës, KFOR-it dhe EULEX-it. Po ashtu, ka kërkuar që tani të zbatohet marrëveshja e Ohrit. “Këto zgjedhje me kaq pak votues nuk sjellin zgjidhje politike. Na vjen keq për mungesën e pjesëmarrjes nga disa parti. Pika pozitive: profesionalizmi i policisë së Kosovës, KFOR / EULEX. Tani duhet të zbatojmë marrëveshjen e Ohrit”, ka shkruar ai në “Twitter”.

Sveçla: Kryetarët e rinj s’do të kenë probleme

Ministri i Punëve të Brendshme i Kosovës, Xhelal Sveçla, shprehu bindjen se kryetarët e rinj të komunave në veri të Kosovës nuk do të kenë probleme në punën e tyre sepse, siç tha, “ligji do të zbatohet në të gjithë vendin”. “Në veri vështirësitë janë më specifike, por probleme nuk do të ketë”, tha Sveçla në një deklaratë për “Radion Evropa e Lirë”.

Molliqaj: Zgjedhjet në veri, argument i ri i Vuçiqit për të ushtruar presion për Asociacionin

Kryetari i PSD-së, Dardan Molliqaj, ka komentuar mbajtjen e zgjedhjeve në katër komunat veriore duke shtuar se nuk zgjidhet problemi i veriut të Kosovës në këtë mënyrë, por vetëm politikisht. Molliqaj ka shkruar në “Facebook” se për kryeministrin Kurti më e rëndësishme është mbajtja e zgjedhjeve në veri sesa rendi e

ligji atje. “Sot Kurti deshi të tregojë që edhe në veri ai mund të mbajë zgjedhje. Për të më e rëndësishme është ta arsyetoje pushtetin e vet sesa ta trajtojë veriun më shumë sesa çështje sigurie dhe e mungesës së rendit e ligjit. Çështja e veriut është çështje politike. Prandaj duhet të trajtohet politikisht. Deri tani veprimet e pushtetit kanë qenë të gabuara e shpeshherë të rrezikshme. Në fund, zgjedhjet e sotme janë argument i ri i Vuçiqit për të ushtruar presion rreth krijimit të Asociacionit”, ka shkruar Molliqaj.



Haradinaj: Mobilizim gjithandej në diasporë për përkrahje të AAK-së

PRISHTINË, 23 PRILL - "Entuziazmi dhe mobilizimi gjithandej në diasporë në përkrahje të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës na jep motiv shtesë që bashkërisht të angazhohemi për një të ardhme më të sigurt për qytetarët dhe për një Kosovë sa më të zhvilluar", ka thënë lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, në një takim me

bashkatdhetarë dhe struktura të AAK-së në Regensburg të Gjermanisë.

"Në takim me bashkatdhetarë dhe struktura të AAK-së, në Regensburg të Gjermanisë, përjetova emocione të veçanta gjatë bashkëbisedimit me ta! Njerëz me profesione e ekspertiza të ndryshme, që jo vetëm na bëjnë krenarë me suksesin e tyre, por i japin

paraqitjen e merituar shtetit të Kosovës, duke e lartësuar identitetin tonë. Kosova ka një histori të lavdishme, rrugëtimi i saj është unik. Ne i takojmë botës perëndimore të udhëhequr nga ShBA, synimi ynë është anëtarësimi i saj në NATO dhe BE - aty e kemi vendin! Jemi bashkë në çdo proces përpara!", ka thënë Haradinaj pas takimit.



Shënohet Dita Botërore e Librit

PRISHTINË, 23 PRILL - Në mbarë botën të dielën është shënuar Dita Botërore e Librit dhe e të Drejtës Autoriale.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka theksuar se kjo ditë është një thirrje për ta rritur mirënjohjen dhe respektin për kontributin e autorëve dhe të librit në progresin shoqëror dhe kulturor të njerëzimit dhe shoqërive. "Rëndësia e librit si mjet komunikimi, arsimimi dhe edukimi është e pazëvendësueshme, andaj institucionet duhet të angazhohen fuqishëm në mbështetje të botimit dhe shpërndarjes së librave dhe mbrojtjes së të drejtës


autoriale. Gëzuar Dita e Librit", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka vizituar njëri nga libraritë e kryeqytetit. "Jam i lumtur që ka mundësi të pafundme për lexim, përfshirë tituj të njohur botërorë. Vite më parë, për shkak të rrethanave të okupimit kur unë isha student, nuk është se ka pasur mundësi në krahasim me atë që sot ofrohet për ata që duan librin", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Në Ditën Botërore të Librit, Hoti ka bërë thirrje për të gjithë, për të rinjtë në veçanti, që të lexojnë më shumë. Data 23 prill është shpallur Ditë Botërore e Librit më 15 nëntor

të 1995-s me një rezolutë të UNESCO-s, pasi u morën në konsideratë faktet se libri ka qenë, historikisht, instrumenti më i fuqishëm i shpërndarjes së njohurive dhe mjeti më efikas për ta siguruar ruajtjen e këtyre njohurive, se çdo nismë për promovimin e librave të rinj është një faktor i pasurimit kulturor etj.

Ideja e përkujtimit të Ditës Botërore të librit e ka origjinën në Spanjë, në zonën e Katalonjës, ku atij që blinte një libër i dhurohej edhe një trëndafil. Më 23 prill të vitit 1616 u ndanë nga kjo botë Servantesi, Shekspiri dhe Garcilaso de la Vega, i ashtuquajtur Inca.



Vazhdon bashkëpunimi i FSK-së me ushtrinë gjermane për ndërtimin e kapaciteteve logjistike

PRISHTINË, 23 PRILL - Gjatë dy javëve instruktorët e Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, nën trajnimin dhe mentorimin e oficerëve gjermanë, zhvilluan trajnimin në mirëmbajtjen, vozitjen dhe licencimin për kategorinë C të instruktorëve të FSK-së. Ministri i Mbrojtjes,

Armend Mehaj, ka thënë se bashkëpunimi i FSK-së me ushtrinë gjermane po vazhdon në ndërtimin e kapaciteteve logjistike dhe edukimit profesional për autoshtetësit e FSK-së, në mbështetje me pajisje dhe ekspertizë. "Këshilltari gjerman rreshter

major Stefan Stieber në kuadër të FSK-së, është më meritor për koordinimin dhe mbështetjen profesionale dhe ndërtimin e aftësive ushtarake në drejtimin e automjeteve në të gjitha kategoritë, përfshirë edhe kategoritë e automjeteve të blinduara", ka theksuar Mehaj.



Shënohet Dita Kombëtare e Turqve të Kosovës

PRIZREN, 23 PRILL - Të dielën është shënuar Dita Kombëtare e Turqve të Kosovës, Dita e Sovranitetit Kombëtar dhe Dita e Fëmijëve në Turqi. Kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj,

së bashku me nënkryetarin e Kuvendit të Prizrenit, Levent Buş, takuan fëmijët e komunitetit turk për t'i uruar për festën dhe për ta kujtuar rëndësinë e diversitetit që është

vlerë e shtetit tonë. "Gëzuar 23 Prillin, Ditën Kombëtare të Turqve të Kosovës, Ditën e Sovranitetit Kombëtar dhe Ditën e Fëmijëve në Turqi!", ka shkruar Totaj në "Facebook".

Policia ndalon automjetin xhip duke transportuar drurë ilegalisht

SHTËRPECË, 23 PRILL - Policia e Stacionit në Shtërpçë, duke u bazuar në planin aktiv "Mbrojtja e Pyjeve", pas disa informacioneve që ka siguruar, të dielën rreth orës 09:00 në fshatin Brod ka ndaluar një automjet xhip që po e drejtonte personi H. S. (M/K), i moshës 17-vjeçar dhe

i cili transportonte drurë ilegalisht nga Parku Kombëtar Malet e Sharrit.

Policia i ka marrë veprimet e nevojshme dhe ka konfiskuar automjetin për dokumentacion të parregullt dhe ndaj drejtuesit ka shqiptuar një gjobë pa patentë shofer dhe tjetrën pa

regjistrim të automjetit, ndërsa ka njoftuar edhe zyrtarët nga Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar (DAPK) "Sharri" të cilët kanë dalë në vendin e ngjarjes dhe kanë shqiptuar fletëparaqitje ndaj personit për transport ilegal dhe drurët më pas i kanë konfiskuar.



Për dy vjet Kosova humbet dy investitorë strategjikë

PRISHTINË, 23 PRILL - Mbi 150 milionë euro investime të planifikuara në dy projekte të investitorëve ndërkombëtarë në Kosovë gjatë dy vjetëve të fundit nuk arritën të jetësohen. Sipas ekspertëve të ekonomisë, kjo është humbje për ekonominë e vendit. Bëhet fjalë për projektin "Çiçavica Wind Farm" për prodhim të energjisë elektrike me erë, të kompanisë franceze "Akvo Energy", dhe atë të kompanisë britanike "Moxico Luma Kosova Mining" për eksplorimin dhe verifikimin e burimeve minerale. I pari, në vlerë mbi 100 milionë euro, i planifikuar nga viti 2021, nuk ka nisur të realizohet për shkak të mospërfundimit të procedurave për dhënien e statusit të investitorit strategjik. Për këtë rast, "Radio Evropa e Lirë" ka raportuar në dhjetor të vitit 2021.

Sipas Ligjit për Investime Strategjike në Kosovë, statusi i investitorit strategjik i jepet atij që i kontribuon rritjes ekonomike, punësimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, apo që ndikon në rritjen e mirëqenies dhe kushteve të jetesës së qytetarëve të Kosovës.

Vëllimi i investimeve për ta fituar këtë status duhet të jetë nga 10 deri në 30 milionë euro, varësisht nga sektori.

Për projektin e dytë të

lartpërmendur, Qeveria e Kosovës këtë javë ka shfuqizuar një vendim të datës 13 dhjetor 2022, me të cilin është konfirmuar "vullneti i Qeverisë për t'i proceduar Kuvendit vendimin për dhënien e statusit 'investitor strategjik' kompanisë 'Moxico Luma Kosova Mining'".

Nga Qeveria e Kosovës thanë për "Radio Evropa e Lirë" se ky veprim është mbështetur në Ligjin për Investime Strategjike që, siç thuhet, i mundëson ekzekutivit të ndërmarrë masa të revokimit për dhënien e statusit të projektit strategjik. Vendimi, sipas qeverisë, është marrë duke iu referuar nenit 14, pika e parë e Ligjit për Investime Strategjike.

Në këtë nen thuhet: "Në rast se përgjatë përgatitjeve dhe zbatimit të projektit investues strategjik, Komisioni [vlerësues] merr dëshmi të reja në bazë të të cilave konstaton dhe vërteton se në projektin investues ka të dhëna të pavërteta apo ndryshim të të dhënave, mbi bazën e të cilave nuk do të ishte vendosur për dhënien e statusit të investimit strategjik, Qeveria e revokon vendimin për dhënien e statusit të investitorit strategjik".

Shpjegime të tjera nuk u dhanë. Kapitali i investimit të kompanisë britanike ka qenë i paraparë të jetë mbi 45 milionë euro. Projekti, po ashtu, ka paraparë punësimin e 300

punëtorëve.

"Radio Evropa e Lirë" ka kontaktuar më 19 prill kompaninë "Moxico Luma Kosova Mining", e cila ka thënë se nuk ka pranuar asgjë zyrtarisht nga Qeveria e Kosovës në lidhje me tërheqjen e statusit të investitorit strategjik.

Të kontaktuar më vonë për t'u informuar nëse e kanë marrë vendimin, zyrtarë të kësaj kompanie nuk kanë pranuar të flasin.

Humbje zhgënjyese e investimeve

Të dyja këto projekte të investitorëve ndërkombëtarë kanë qenë të fokusuara në komunën e Vushtrrisë, e cila gjendet rreth 25 kilometra larg Prishtinës.

Ish-kryetari i kësaj komune, Xhafer Tahiri, i cili, derisa ka qenë në këtë pozitë, u ka dhënë mbështetje projekteve, thotë se mosrealizimi i tyre është humbje për ekonominë e Kosovës. "Më vjen shumë keq që një investitor i madh po i largohet Vushtrrisë, në fakt i dyti, sepse kemi pasur edhe një projekt në energjinë e ripërtërishme që nuk është realizuar. Është zhgënjyese, sepse ne po e shohim mungesën e perspektivës ekonomike në vendin tonë dhe faktin se sa shumë të rinj po largohen nga Kosova", thotë

Tahiri për "Radio Evropa e Lirë".

Ai kujton se në projektin e kompanisë "Moxico Luma Kosova Mining" zyrtarët e komunës janë pajtuar me investitorin që t'i jepte përparësi punësimit të qytetarëve të Vushtrrisë. Sipas vlerësimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), komuna e Vushtrrisë i ka rreth 62 000 banorë.

Të dhënat e ASK-së tregojnë se papunësia në nivel vendi është mbi 20 për qind.

Ish-kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Safet Gërxhaliu, thotë se në Kosovë investitorët ndërkombëtarë ikin çdo ditë e më shumë. "Derisa vendet e rajonit po bëjnë çmos t'i tërheqin investitorët e huaj, ne i largojmë. Ky është një fakt shqetësues. Kemi dy investitorë të mëdhenj që janë larguar brenda dy vjetëve nga Kosova. Lind pyetja: Si është e mundur që të kemi zhvillim ekonomik nëse i refuzojmë investitorët e huaj?", thotë Gërxhaliu. Sipas tij, investitorët që largohen nga Kosova priten në Maqedoninë e Veriut ku, siç thotë, procedurat për plotësimin e dokumenteve të nevojshme për investime, për dallim nga Kosova, kryhen brenda tre muajsh.

"Radio Evropa e Lirë" ka raportuar në vitin 2021 se kompania franceze për prodhim të energjisë elektrike

"Akvo Energy" as pas tre vjetësh përpjekjeje nuk ka arritur t'i përfundojë procedurat për një investim milionësh në Kosovë, por i ka përfunduar ato në Maqedoninë e Veriut brenda muajsh.

Në raportet e Bankës Botërore "Të bërit biznes", si arsye për mungesë investimesh në Kosovë, është përmendur shpesh infrastruktura e komplikuar ligjore.

BQK: Mbi 750 milionë euro investime të huaja

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës, investimet e huaja në Kosovë në vitin 2022 kanë kapur vlerën e mbi 750 milionë eurove - nga mbi 420 milionë euro sa kanë qenë në vitin 2021.

Investimet më të mëdha bëhen në sektorin e patundshmërisë dhe ato vijnë kryesisht nga diaspora e Kosovës. Sipas BQK-së, Gjermania është shteti me më së shumti investime të huaja direkte, e pasuar nga Zvicra. Këto njëherësh janë dy shtete ku jeton numri më i madh i qytetarëve nga Kosova.

Kosova prej vitesh përballet me probleme ekonomike. Rritja ekonomike vjetore nuk kalon 4 për qind, shifër e pamjaftueshme për ta adresuar problemin e papunësisë sipas ekspertëve.



Eurozona regjistron suficitin e parë tregtar më 17 muaj

PRISHTINË, 23 PRILL - Bilanci tregtar i Eurozonës shënoi suficit prej 4.6 miliardë eurosh në muajin shkurt. Siç njofton Zyra Evropiane e Statistikave, vendet e kësaj zone kanë dalë nga deficitit për herë të parë rreth një vit e gjysmë. "Eurozona për herë të parë që nga shtatori 2021 regjistroi tepriçë prej 4.6 miliardë eurosh në tregtinë e mallrave me pjesën tjetër të botës në shkurt 2023, krahasuar me

deficit prej 9.4 miliardë eurosh në shkurt 2022", njofton Eurostat.

Eksportet e mallrave të Eurozonës në pjesën tjetër të botës u rritën 7.6 për qind në bazë vjetore në 232.7 miliardë euro në shkurt, ndërsa importet u rritën me 1.1 për qind në 228.1 miliardë euro. Tregtia brenda Eurozonës arriti në 224.4 miliardë euro në shkurt, 8 për qind më shumë se një vit më parë.

Vendet e Bashkimit Evropian panë një suficit tregtar për herë të parë që nga qershori 2021, duke arritur në 4.8 miliardë euro në shkurt.

Vlerësimi i parë për eksportet e mallrave jashtë BE-së ishte 207.7 miliardë euro, duke u rritur me 8 për qind krahasuar me të njëjtin muaj të vitit të kaluar, ndërsa importet nga pjesa tjetër e botës mbetën në 202.9 miliardë euro, me një rënie prej 2.8-përqindësh.



SHITËSI DHE BLERËSI



Berat ARMAGEDONI

Java e dytë e muajit të tretë kishte filluar. Fazli Qopa në dy javët e fundit as nuk kishte ardhur në shitore, as nuk kishte kaluar rrugës ku Bislim Barku e kishte shitoren. Qopa e kishte shtëpinë në lagjen Kodra, ndërsa Barku e kishte shtëpinë dhe shitoren në lagjen Rrafshi. Nuk ishte kushedi çfarë kodre. Ishte një përpjetë e shkurtër në krahasim me rrafshin. Kushedi për çfarë arsye i kishte mbetur ai toponim krejt kot. Në gjithë fshatin Ukshaj kishte vetëm dy shitore ushqimore. Njëra ishte e Rifatit, tjetra e Bislimit. Në to kishte mallra të mjaftueshme për njëqind e dyzetë e tetë shtëpitë e lagjeve të fshatit dhe për një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një banorët e tij. Në to gjeje gjithçka. Mund të gjeje edhe ilaçe për dhimbje të kokës. Çfarëdo që mbante Rifati në shitore, mbante edhe Bislimi.

Të dy shitësit, ani pse nuk kishin asnjë marrëveshje, blerësit i kishin ndarë thikë përgjysmë. Për çudi, banorët e lagjes së Rifatit, që ishin kryesisht arsimtarë dhe profesorë të shkollave, shkonin blinin në shitoren e Bislimit, kurse ata të lagjes së Bislimit shkonin blinin në shitoren e Rifatit e që ishin kryesisht punëtorë të fushës e të maleve. Rrallë ndonjë prej tyre ishte mësues ose punonjës fabrike. Fqinjët e parë, ndoshta për shkak të xhelozisë që u shkonte biznesi mirë, nuk donin t'ua shtonin edhe më shumë pasurinë fqinjëve të vet.

Fazli Qopa ishte fqinji i dytë i Rifatit. Çdo dy-tri ditë, pasi kalonte kah shitoret e tij, bënte tetëqind metra rrugë këmbë dhe vinte blinte gjësende në shitoren e Bislimit. E nëpërkëmbte punën e fqinjët të vet dhe shitësin të cilin, gjatë pranverës, pasi e shihte para shitores duke marrë rreze dielli të nevojshme për lëkurën, vetëm e përshëndeste teksa kalonte para tij me qeset e mbushura me mallra që blinte në shitoren tjetër. Fazliu dhe Rifati nuk kishin raporte aq të mira dhe, ani pse shtëpitë i kishin afër njëra-tjetrës tridhjetë metra, bisedë më të gjatë sesa një përshëndetje nuk bënin me njëri-tjetrin as kur takoheshin në ndonjë të pame dhe gazmend familjar të fqinjëve. Por, meqë dy javë kohë Fazliu nuk kishte shkelur në shitoren e Bislimit, këtij i ishte mbushur mendja se ai është duke blerë gjësende ushqimore në shitoren e Rifatit. Pasi i ishte krijuar kjo bindje, e pyeste të birin dhe të bijën, të cilët bashkë me të punonin në shitore, nëse e kishin parë ndonjë ditë duke kaluar kah shitoret ose nëse kishte qenë ndonjë ditë në shitoren e tyre kur ai nuk kishte qenë aty. I biri i tha as nuk ka qenë as nuk e ka parë.

Edhe e bija iu përgjigj njëjtë. Bislimi mendoi pak kohë dhe foli: – Çudi kah shkon ai në shkollë! Rrugë tjetër përpos kah shitoret jonë s'ka. Duhet me e pyet nesër Brahimin për të se a është duke dalë në shkollë.

E bija, pasi e dëgjoji të atin me vëmendje, i tha: – Po, në shkollë po vjen. Sot patëm mësim me të. – E qysh po vjen në shkollë pa kaluar kah shitoret jonë se?!, – shprehi mëdyshje Bislimi. Ashtu si e bija, edhe i biri i thanë, “vetëm nëse shkon trup arave”.

– Aha, aha... – bëri dy a tri herë dhe i kërkoi të bijës fletoren e borxhlinjve. Në faqen 36 të saj e gjeti emrin e Fazli Qopës. E mblodhi borxhin e tij të një muaji dhe, në fund të faqes, shkroi shifrën e përgjithshme 465 marka dhe poshtë saj “s'ka më veresi”. U bëri me dije fëmijëve që më mos t'i jepnin veresi asnjë sakëz. Vajza, kur mori urdhrin e të atit, u ndie pak keq dhe iu afrua të vëllait dhe me gjysmë zëri i tha: – Më vjen marre mos me i dhanë veresi mësuesit Fazli. Sa herë që vjen ai unë do të dal prej shitores se nuk mund ta kthej mbrapsht duarthatë. Vëllai ia tumiri kërkesën vetëm me lëvizje të kokës ndërsa i ati, që bëhej kinse nuk po e dëgjonte të bijën, tha: – Ky nuk është ma myshteri i joni dhe pa i shku te dera me ia lyp borxhin, s'na shkel derën kurrë ma.

E bija deshi të fliste diçka, por fjalën nuk e la ta nxjerrë i ati i saj, i cili e porositi: – Emë, thuaj nesër mësuesit Fazli baba të ka çu të fala dhe ka thënë hajde lama borxhin.

U rrëqeth e tëra sikurse të ishte duke shtyrë lopatën në ndonjë pllakë çimentoje. S'mund të fliste asnjë fjalë. I ati ia përsëdyti: – A more vesh? Me një ton të ulët dy herë i tha “po, po”. Ndjenjën bashkë krejt edhe pesë a gjashtë minuta dhe u shpërndanë nëpër dhoma të gjumit.

Mëngjesi në shtëpinë e Bislimit kishte zbardhur. Edhe pse zakonisht binte më herët dhe çohet më herët sesa gruaja, këtë mëngjes ishte zgjuar më vonë se ajo. U vesh, u mbath, doli në oborr dhe e pa gruan duke u hedhur grurë pulave dhe duke bartur ushqim për kafshët në ahur. E porositi t'i bëjë një kafe dhe t'ia sjellë në shitore. Tërë atë ditë, edhe pasi u kthye së pari djali, pastaj vajza, e cila i bëri me dije se nuk e ka parë mësuesin Fazli sot në shkollë dhe i thanë se kanë ardhur ta ndërrojnë, ndenji vetë në shitore. Prite ta shihte Fazliun. Por, as atë ditë nuk e pa. Në vend të tij pasdite erdhi myshteri i tij më i rregullt, Brahim, i cili, ashtu si Fazliu, ishte mësues në shkollën e fshatit. Gjithë pasditen, pasi e përfundonte orarin e mësimin në shkollë, derisa perëndonte dielli, Brahimi vinte pinte birra të Malësisë në shitoren e Bislimit dhe i rrëfente për ndodhitë e mësuesve dhe të nxënësve në shkollë. Në javën e parë pas marrjes së rrogës, hante edhe meze, zakonisht ndonjë narezak,

pas javës së dytë vetëm sallam dhe ndonjë copë të vogël të suxhukut industrial. Në javën e fundit të muajit pinte vetëm birrë, e cila, pa meze, e mundonte shumë. Ndodhte që vllte edhe në lokal. Edhe pse e kishte mundësinë dhe besimin, nuk donte të hante dhe të pinte veresi. Derisa ai po i rrëfente për një ndodhi, për një përleshje mes dy mësuesve në shkollë, për të cilën Bislimi nuk shprehte interesim të madh, e pyeti:

– Brahim, a ma ke pa Fazlin bre?! – Po, sot ndenjëm në sallën e arsimtarëve dhe e ndërroam nga një cigare.

– Po a po vjen në shkollë?! – Po, po, për çdo ditë, – i bëri me dije Bislimi.

– E te ti, a po vjen?, – e pyeti Brahim.

– Jo, sot e pesëmbëdhjeta ditë që as nuk ka ardhë këtu, as nuk ka trupin knejpari.

– Mos të ka borxh?!, – shprehi kureshtje Brahim.

– Po, m'ka rreth 500 marka.

– Mos u bëj merak, se t'i jep – dhe dredhi në grykën e fytit nja gjysmë litri birrë.

– Qare s'ka, se ka ble harxh, por duhet me u ba i gjallë bre, me i ra pak kah dera jeme prapë, – tha Bislimi.

– Ndoshta tash blen te Rifati, se e ka kushëri, – ia sollti ndër mend shitësin tjetër dhe nuk i erdhi mirë që e dëgjoji emrin e tij.

– Le t'blen ku të don, por borxhin ai duhet me ardhë me ma la. Ka pesëmbëdhjetë ditë që e ka marrë rrogën dhe s'po i shkon mendja me ardhë me pagu borxhin, as me ardhë me ble harxh ma. Është e pamundur gjithë këtë kohë mos me ble, të paktën, një biber a një kafe, – shprehi mendimin dhe shqetësimin e vet Bislimi dhe bëri me dije se sonte ka ndër mend të shkojë t'ia lypë borxhin.

– Më mirë çoje djalin, – i sugjeroi Brahim, Bislimit.

– Mirë e ki, mirë e ki, – tha një pas një dhe disi mendueshëm.

Doli nga shitoret dhe pas pak u kthye brenda sërish. Dhjetë sekonda më pas në shitore erdhi edhe i biri i tij, Sherifi.

– Djali jem, shko deri te mësuesi Fazli dhe thuaj m'ka çu baba me ma pagu borxhin, se i kam puntë keq.

Djali, ashtu si vajza një natë më parë, hezitoi. I vinte keq t'i shkonte te shtëpia. Nuk ishte mësuar të shkonte te borxhlinjtë t'ua kërkonte borxhet, as t'ia mblidhte borxhet babës, aq më pak të mësuesve të vet dhe të motrës.

– Hajt se e takoj nesër në shkollë dhe i them, – i tha të atit.

– Jo nesër, jo në shkollë, por sot dhe te dera e shtëpisë. Nisu! – i dha urdhrin e ati.

Nuk bëzani dhe, me keqardhje, trup arave, u nis drejt përpjetës për te shtëpia e Fazliut. Eçjen e tij derisa shkonte arave nga dritaret e shitores e vëzhgonin Bislimi dhe Bajrami dhe gjithë kohën, derisa djali u kthye në shitore, folën vetëm për Fazliun.

– Babë, mësuesi Fazli nuk ish

kanë aty. Ndoshta a ka, por nuk doli. Doli gruaja e tij dhe tha: – Pasha zote, more ti djali i Bislimit, veç nëse na merrni një lopë ose shpirtin, se finikun n'shpi s'e kemi. Bislimi e dëgjoji me vëmendje dhe nisi të bëhet nervoz. Brahimi përpiqej ta qetësonte.

– T'i jep, t'i jep. Askush borxh deri sot nuk të ka mbetur, – ia kujtonte ai.

– As s'ka me mbet kush, o Bajram, se me pare t'miat e kam ble ata harxh që e ka hangër Fazlia me familje. S'ma ka fal kërkush ata mall. Po çka me ba se m'paska ba kahre mu me shku deri te shtëpia e tij, se veç ia ngjes qasaj lope për kërpeshi dhe e bi n'shpi.

Djali nuk bëzante, Bajrami veç derdhte birrë në fyt dhe e mbushte barkun, Bislimi veç ofshante. Mezi e kaloi atë pasdite dhe atë natë në shitore dhe në shtëpi. Një mendim i vinte, një tjetër i shkonte. Sa ndiente keqardhje për gjendjen e Fazliut dhe të familjes së tij, aq ndiente edhe për vete dhe familjen: – Na me këtë shitore po mbesim gjallë. Një markë prej shtetit s'e marr kurrë. Ai çdo muaj e merr rrogën.

Ra atë natë në shtrat, i rënduar shumë dhe nervoz. Gjumi s'i vinte, shqetësimet i shtoheshin. Në mesnatë e bindi veten që nesër pasdite, pasi të kthehej Fazliu në shtëpi nga shkolla, t'i shkonte te dera e oborrit dhe t'i thoshte ose paguaj borxhin me para, ose jepma lopën për të. Herë pas here njëfarë droje i vinte. Nuk kishte guxim të shkonte duarthatë. Dikush, një genie abstrakte përbrenda tij, i thoshte se nuk i shkohet njeriut te dera e shtëpisë duarthatë. Çfarë nëse Fazliu të thotë as nuk ta paguaj borxhin, as nuk ta jap lopën. Çfarë nëse të thotë pushka top t'u bëftë! Pastaj kur i kujtohej se mësuesi i historisë kishte dhënë kontribut atdhetar ndër vite, në qytetin e tyre kishte organizuar edhe protesta, nuk e kishte bash të lehtë t'i dilte përballë. Natën vonë shkoi në ahurin e lopëve dhe, përposh grazhdit të kafshëve, mbështjell nën një qese najloni të zezë e të mbuluar me kashtë, mori dhe nxori një revole të vogël. E kontrolloi karikatorin e saj. I numëroi një, dy, tre, katër, pesë fishkë. E futi në brez dhe u kthye në dhomën e gjumit, por gjumë nuk bëri as pesë minuta. Ofshama, po, nxirrte vazhdimisht, edhe djersë. Kishte siklet të madh. E paramendonte çdo situatë të ligë para shtëpisë së mësuesit Fazli.

Të nesërmen e hapi shitoren ende pa gdhirë dita mirë. Vështronte arat përballë shitores, andej kah e kishte shtëpinë mësuesi Fazli. Mezi s'priste ta shihte Fazliun duke ecur nëpër to derisa shkonte në shkollë. Nuk e pa asgjekund gjithë ditën e as pasdite. Pas orës 13.00 djali u kthye nga shkolla dhe erdhi ta ndërrojë babanë në shitore. Sapo e pa të atin nuk iu duk se kishte

çehre të mirë. As nuk i tha gjë ai, as nuk i tha gjë ky. Bislimi vetëm doli nga shitoret dhe, duke prekur brezin me duar, ia mësyu shtëpisë së Fazliut trup arave nga, një ditë më parë, kishte rënë i biri i tij. Teksa shkonte te Fazliu, Bislimi fliste ndër vete: Ev Fazli, ev! Telashe vetes, telashe mu.

Ende pa mbërritur te dera e shtëpisë së tij, i pa dy njerëz te dera e tij. Njëri e kishte kapur një lopë për kërpeshi dhe e ngrehte, tjetri i mëshonte thupër vitheve. Me ta ishte edhe Fazliu që u thoshte “për hair ju qoftë!” Për një çast mendoi se, tash që këta borxhlinj ia morën lopën, çfarë t'i marr unë. Sipas guas së mësuesit, tash atyre u kishte mbetur veç shpirti. Pasi ata bënë nja njëqind metra përtej shtëpisë së tij, Bislimi kapërceu rrugën kryesore dhe trokiti tri herë rëndë në dyert e oborrit të tij dhe thirri: O Fazlioooo... Nuk kishte nevojë për një thirrje tjetër sepse ishte e madhe dhe e gjatë. Pas pak Fazliu hapi derën e dyerve të oborrit dhe, pas përshëndetjes me të, e ftoi të hynte brenda.

– S'kam ardhë me nejtë, mësues Fazli. Kam ardhë për... – i vinte vështirë t'ia thoshte arsyen, sepse ai mund ta merrte me mend çfarë kërkonte para derës së tij.

– Ke bërë mirë që ke ardhur, se ka disa javë që stë kam parë dhe qenkam përmallur për ty. Po eja brenda të pimë nga një kafe dhe të bisedojmë – dhe e kapi për krahu në shenjë respekti, por këtë gjest të tij nuk e priti mirë Bislimi, i cili hapi gojën dhe foli:

– Nuk kam kohë as për një kafe. E kam lanë shitoren vetëm. Erdha për qata borxh, – ia kujtoi, më në fund, ardhjen te pragu i shtëpisë. – Po bre Bislim, po e di që për pare ke ardhur, se po të merrte malli për mua do të vije para dy jave. Edhe paratë do t'i jap, me kësmet. – Menjëherë, – i tha Bislimi, – menjëherë, – ia përsëdyti kërkesën që mësuesit i dukej urdhër.

– Po a di gjë sa të kam borxh?, – e pyeti teksa vetë nxori një bllok shënimesh nga këmisha.

– 465 marka t'gjermanit. Rrafsh një lopë! – i tha me ton të lartë dhe vështroi goxha larg dy njerëzit që ecnin paralelisht me lopën e tij.

Pasi verifikoi bllokun e shënimeve, në të cilin mësuesi Fazli kishte regjistruar të gjitha blerjet nga shitoret e Bislimit, i nxori 500 marka nga kuleta dhe ia lëshoi në dorë.

– Qe borxhin, Bislim, e ma bëj hallall. Derisa e shita lopën për këto pare s'kisha ku t'i merrja tjetër e as nuk kisha fytyrë të kaloja kah shitoret jote e të të dilja përballë. E kemi pasur një rast në familje e rroga m'u shpenzua shpejt dhe krejt.

Bislimi e kapi pesëqindëshen në duar dhe te shiriti i saj, me fërkim te gishtit i madh dhe tek ai tregues, verifikonte mos janë false. Pasi u sigurua se janë origjinale, i futi në xhup. Asnjërit nuk i shkoi mendja t'i thotë se janë 35 marka për kusur. Megjithatë, Bislimi i tha diçka: – Mësues, derën çel e tek unë ditën dhe natën. Mirë se vjen!

Gjermania Lindore, “fytyra njerëzore” e socializmit



Nga Jacob MIKANOWSKI

Gjermania Lindore është një nga fantazmat e Evropës. Katja Hoyer është mjaftueshëm e madhe në moshë për të kujtuar vdekjen e saj. Në tetorin e vitit 1989, kur ajo ishte 4-vjeçe, babai i saj e mori në një vizitë në majën e Fernsehturm në Berlin, ose Kulla e Televizionit.

Në atë kohë, por edhe sot, godina më e lartë në Gjermani, kjo “kryevepër e arkitekturës socialiste” u ndërtua midis viteve 1965–1969, si një dëshmi e aftësive teknologjike të Gjermanisë Lindore. Por në atë ditë tetori, kur Hoyer hodhi sytë poshtë, pa skuadrat e “Policisë Popullore” që po arrestonin protestuesit në sheshin e madh.

As policët dhe as protestuesit, nuk mund ta dinin se Muri i Berlinit do të rrëzohej brenda një muaji. Dhe as që e imagjinonin që pas një viti, Republika Demokratike Gjermane (RDGJ) do të pushonte së ekzistuari. Tridhjetë vjet pas vdekjes së saj, Hoyer, tashmë gazetare dhe historiane, është rikthyer në tokën e saj të lindjes, me këtë histori të pasur dhe kundër-intuitive të një vendi të cilësuar shumë shpeshherë si fanatik apo një “aksident” i Luftës së Ftohtë.

Megjithatë, Gjermania Lindore e Hoyer-it nuk është “Stasiland” i rrethuar nga muret, i kontrolluar nga Rusia, dhe qytetarët e të cilit vuanin nga mbikëqyrja dhe kërcënimet e vazhdueshme nga Ministria e Sigurimit të Shtetit. Përkundrazi, në rrëfimin e saj, para

syve na del një vend ku njerëzit formësonin fatet e tyre dhe jetonin një jetë “plot ngjyra”, shumë larg “grisë monotone” që kishte krijuar imagjinata perëndimore.

Papunësia gati nuk ekzistonte. Strehimi ishte i disponueshëm për të gjithë dhe relativisht i lirë. Po ashtu Gjermania Lindore e Hoyer ishte një shtet, udhëheqësit e të cilit, megjithëse të mbështetur nga Ushtria e Kuqe, dhe të varur nga Bashkimi Sovjetik për lëndët e para të rëndësishme (sidomos nafta), u përpoqën të ndiqnin një trajektore të pavarur në vend dhe skenën ndërkombëtare.

Rrëfimi i saj është kryesisht një histori politike, edhe pse i ndërthurur me intervista me gjermano-lindorë të zakonshëm, “mësues, kontabilistë... punëtorë të fabrikave”, dhe më shumë me “oficerët e policisë dhe rojet kufitare”, të cilët bënë të mundur funksionimin e këtij shteti.

Fillimisht nën pushtimin e ushtrisë sovjetike pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Gjermania Lindore u bë një vend i pavarur më 7 tetor 1949. Por historia që tregon Hoyer në librin e saj të fundit “Përtej Murit” nis shumë më herët, me luftën e Partisë Komuniste gjermane për të mbijetuar “midis Hitlerit dhe Stalinit”.

Në prag të Luftës së Dytë Botërore, anëtarët e kësaj partie u përballën me arrestime dhe tortura në Gjermaninë naziste. Terrori detyroi mërgimin në Bashkimin Sovjetik të pjesës më të madhe të udhëheqjes së saj. Aty shumica e tyre u zhdukën, qoftë në gulagë

apo duke u pushkatuar gjatë spastrimeve të mëdha të Stalinit. Atë që mbijetuan dhe morën kontrollin e Gjermanisë Lindore pas luftës, ishin të kalitur në beteja dhe tërësisht besnike ndaj padronëve të saj sovjetikë. Të sjellë në Gjermani nga Ushtria e Kuqe pushtuese, liderët e partisë – si Ëalter Ulbricht dhe Ëilhelm Pieck – filluan të vendosin një diktaturë të udhëhequr nga komunistët në zonën e pushtuar nga sovjetikët.

Brenda pak vitesh, ata arritën të transformonin me shpejtësi organizimin social, ekonomik dhe politik të lindjes duke rishpërndarë tokën, shtetëzuar industrinë, dhe duke shuar çdo opozitë të organizuar politike. Gjatë këtij procesi, ata shkaktuan një eksod të madh përtej kufirit ende të hapur në Perëndim.

Pas vdekjes së Stalinit në vitin 1953, Partia Komuniste (që e ndryshoi emrin në Partia e Unitetit Socialist, SED) e sundoi Gjermaninë Lindore me një përzjerje të represionit dhe pajtueshmërisë së njerëzve. Nga njëra anë, u zgjerua shumë roli i sigurimit të shtetit, i STASI-it të frikshëm.

Nga ana tjetër, udhëheqja e partisë bëri gjithçka që mundi për të siguruar që të gjithë gjermano-lindorët të ishin të paktën të punësuar dhe të plotësoshin nevojat e tyre bazë.

Por nuk mjaftoi. Për sa kohë që mbeti hapur një rrugë shpëtimi në qytetin e ndarë të Berlinit, nga Gjermania Lindore vazhduan të largohen punëtorë të aftë drejt pjesës perëndimore.

Deri në vitin 1961, gati 300.000 njerëz largoheshin nga RDGJ çdo vit. Atë vit, kreu i partisë së RDGJ-së dhe lideri i padiskutueshëm, Ulbricht, vendosi t'i jepte fund njëherë e përgjithmonë këtij fenomeni duke ndërtuar Murin e Berlinit, diçka që ai e arriti (të paktën në fazën fillestare, me hunj dhe me tela me gjemba) praktikisht brenda natës dhe pavarësisht kundërshtimeve të padronëve të tij sovjetikë.

E bllokuar pas telave me gjemba, por gjithnjë e më e begatë, Gjermania Lindore filloi t'i ngjante kafazit të praruar të bllokut lindor, të paktën në sytë e fqinjëve socialistë. Megjithatë, siç e thekson Hoyer, zhvillimi ishte real: Gjermania Lindore gëzonte vërtet standardin më të lartë të jetesës nga çdo shtet tjetër socialist.

Kujdesi i madh për fëmijët, i dha mundësi grave të hynin në fuqinë punëtore me një shkallë më të lartë se në çdo vend tjetër në botë. Siç kujton Erika Krüger, një nga punëtorët e intervistuar nga Hoyer, jeta në vitet 1970-1980 ishte shumë e lumtur: “Ne punonim, merrnim rregullisht rrogën si dhe shpërblimet për punën e palodhur. Ia dilnim fundit të muajit dhe nuk kishim asgjë për t'u shqetësuar”.

Vetëm kur Krüger vizitoi kumatën e saj në Gjermaninë Perëndimore, e kuptoi hendekun në standardet e jetesës midis lindjes dhe perëndimit. Por nëse Gjermania Lindore mbeti prapa në prodhimin e mallrave të konsumit dhe veçanërisht ato të luksit, një nga surprizat e shumta të lbrit “Përtej Murit” është zbulimi i

sakrificave që ishte gati të bënte lidhshipi gjermano-lindor për të mbajtur popullsinë e saj të furnizuar me mallrat e importuara, dhe me ushqimet që i konsideronte thelbësore për mirëqenien e tyre emocionale.

Njerëzve iu siguroa stabilitet, një zhvillim relativ dhe lëvizshmëri sociale. Ishte një shtet punëtorësh që kujdesej për interesat e punëtorëve. E gjitha kjo shtron pyetjen: Pse ndërtoi në të njëjtën kohë sistemin më të madh të sigurisë për frymë që ka njohur ndonjëherë bota? Hoyer ia vë pjesën më të madhe të fajit “paranojës”, veçanërisht nga ana e shefit të fshehtë të STASI-t, Erich Mielke. Por një njeri nuk bën dot gjithë sistemin. Pikërisht këtu dikush do të donte që Hoyer ta kishte zgjeruar analizën e saj nga Gjermania Lindore tek blloku lindor në tërësi.

Një këndvështrim krahasues, mund ta kishte bërë më të qartë veçorinë e arritjeve të Gjermanisë Lindore por edhe tragjedinë e saj. Të dyja i kishin rrënjët tek i njëjti fakt gjeografik. Si pjesë e një Gjermanie më të madhe të paraluftës, Gjermania Lindore u përball me kundër-shembullin e vazhdueshëm të Republikës Federale fqinje.

Afërsia e madhe (ndahej vetëm nga një mur) e inkurajoi udhëheqjen e saj ta bënte sa më efektiv që të ishte e mundur versionin e tyre të socializmit “më fytyrë njerëzore”. Po ashtu, i nxiti ata të krijonin një nga sistemet më të gjera të kontrollit që ka parë ndonjëherë bota. / *The Guardian* – Bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Invert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Prishtina në plejof

PRISHTINË, 23 PRILL - Prishtina ka siguruar biletën e fundit për në plejofin e Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt). Prishtina ka përfunduar kampionatin e rregullt në pozitën e katërt dhe në gjysmëfinale të plejofit do të takohet me Besa Famgasin

e Pejës. Të shtunën në kuadër të xhiros së fundit të Superligës A, xhiros së 28-të, Prishtina fitoi ndaj Kastriotit të Ferizajt me rezultat 52:36. Oltion Beshiri, Sergio Barreto e Enis Kuleta i shënuan nga nëntë gola për Prishtinën. Jeton Bislimi e Agon Bytyqi

shënuan nga gjashtë gola për Kastriotin. Prishtina ka përfunduar e katërta me 27 pikë, ndërsa Kastrioti i gjashti me 19 pikë. Kalimin e Prishtinës në vendin e katërt ia ka mundësuar edhe fitorja e Besa Famgasit ndaj Rahovecit. Besa ka përfunduar e para me

50 pikë, ndërsa Rahoveci ka rënë në vendin e pestë me 25 pikë. Besa fitoi ndaj "vreshtarëve" me rezultat 35:30. Rahovecit i duhej fitorja për të mbetur në vendin e katërt. Atë e ka kërkuar deri në fund, por megjithatë Besa shënoi fitore.



Ballkani ruan kreun, Drita fiton ndaj Prishtinës

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 PRILL - Tri ndeshje të javës së 30-të janë zhvilluar të dielën në elitën e futbollit të Kosovës. Kampionia në fuqi, Ballkani ka shkëlqyer ndaj Trepçës '89 duke fituar me rezultat bindës 7-2. Sulmuesit Albin Berisha dhe Albion Rrahmani shënuan nga dy gola, ndërsa nga një gol e shtuan Lumbardh Dellova, Edvin Kuq dhe Van Dave Harmon. Golat për 89-shin i shënuan Armend Gashi dhe Adu-Këaë. Ballkani pas kësaj fitore është në vendin e parë me 61 pikë, një më shumë se Drita e Gjilanit që pozicionohet e dyta. Llapi në ndeshjen ndaj Dukagjinit nuk



ka arritur me shumë se në një barazim edhe pse ishte vendas (1-1). Arbër Shala realizoi fillimisht në minutën e 25-të për Dukagjinin, ndërsa Festim Alidma riktheu baraspeshën në rezultat në minutën e 29-të. Në ndeshjen

e tretë, Gjilani shënoi fitore kundër Drenicës me rezultat minimal 1-0. Golin e fitores e realizoi Baton Zabërxha në minutën e 50-të. Fitore shumë të rëndësishme në garë për titull realizoi skuadra e Dritës që e mposhti Prishtinën me

rezultat minimal 1-0. Golin e vetëm për gjilanasit e shënoi Kastriot Selmani, në minutën e 42-të. Malisheva arriti të shënojë fitore të madhe, me rezultat 2-1 ndaj Ferizajt. Ferizaj nga minuta e dymbëdhjetë luajti me një futbollist me pak, pasi iu përjashtua portieri. Pesë minuta me vonë Malisheva kaloi në epërsi me golin e Robert Sobowales. Ferizaj nuk u dorëzua dhe në minutën e 71-të pas shumë përpjekjeve arriti të barazojë shifrat me golin e Betim Haxhimusës. As pas barazimit ferizajasit nuk u ndalën dhe u vërsulën në kërkim të golit të fitores, gjë e cila u kushtoi me pësim të golit, pasi Malisheva kishte epërsi numerike dhe në

SUPERLIGA

Ballkani - Trepça '89	7-2
Ferizaj - Malisheva	1-2
Drita - Prishtina	1-0
Gjilani - Drenica	1-0
Llapi - Dukagjini	1-1

Tabela

1. Ballkani	61 pikë
2. Drita	60
3. Gjilani	46
4. Prishtina	41
5. Dukagjini	40
6. Llapi	40
7. Malisheva	33
8. Trepça '89	33
9. Ferizaj	31
10. Drenica	23

minutën e 83-të, Sobowale shënoi sërish, duke vulosur fitoren për skuadrën e tij.

Trepça barazon serinë gjysmëfinale ndaj Prishtinës, Peja kualifikohet në finale

"Epoka e re"

MITROVICË, 23 PRILL - KB Trepça ka triumfuar në gjysmëfinalen e katërt të "play-off"-it ndaj Sigal Prishtinës me shifrat 82:77 (20:22, 20:16, 24:25, 18:14). Tashmë seria është barazuar në 2:2, ndërsa ndeshja e ardhshme në Prishtinë do të vendosë se, kush do t'i bashkohet Pejës në finale. Takimi në "Minatori" ishte shumë interesant, duke u vendosur në çastet e fundit, ndërsa palestra ishte e stërmbushur me tifozë. Edhe pse vendasit e nisën shumë më mirë me epërsi prej dhjetë pikësh 17:7, prishtinasit u

rikthyen shpejt, duke fituar çerekun e parë 20:22. Në periudhën e dytë, mitrovicasit kishin epërsi të lehtë, sidoqoftë, pjesa e parë përfundoi 40:38. Perioda e tretë ishte tërësisht e barabartë, duke bërë që fituesit të vendosej në fund. Kështu edhe ndodhi, ku "Xehetarët" në fund ishin më të vëmendshëm dhe fituan 82:77. Te vendasit u dalluan Jamel Artis me 16 pikë e pesë kërcime dhe Drilon Hajrizi me 11 pikë e nëntë kërcime, kurse te mysafirët u dalluan Dardan Berisha me 23 pikë e gjashtë asistime dhe Both Gash me 16 pikë e 12 kërcime. Peja është skuadra e parë që është kualifikuar në finale të "play-



off"-it. Pejanët në ndeshjen e katërt gjysmëfinale kanë mundur Golden Eagle Yllin me rezultat 90:100 (13:30, 19:20, 38:25, 20:25). Peja me serinë 3:1 u kualifikua në finale. Mysafirët e nisën për mrekulli ndeshjen, me epërsi të dyfishtë 9:18, dhe më

pas vetëm sa e ngritën epërsinë, duke e fituar çerekun e parë 13:30. Periudha e dytë ishte më e niveluar, ku vendasit tentonin rikthimin, ndërsa mysafirët ta shtonin epërsinë, kurse pjesa e parë përfundon 32:50. Pejanët në periodën e tretë kishin

epërsinë më të lartë, 22 pikë, pranë shifrave 32:54 dhe 45:67, por kampionët nuk dorëzohen dhe u rikthyen fuqishëm për të afruar rezultatit në 70:75, sa ishte rezultati pranë 30 minutash lojë. Rezultati u ngushtua edhe më shumë në fillim të çerekut të fundit, 73:75, megjithatë vendasit nuk arritën të bëjnë më shumë, ndërsa lojën e menaxhuan mirë pejanët që fituan në fund 90:100. Te Ylli u dalluan Bashir Ahmed me 21 pikë e 13 kërcime dhe Gëzim Morina me 20 pikë, kurse te Peja u dalluan Brad Waldow me 17 pikë e 13 kërcime dhe Arian Qallaku me 22 pikë e gjashtë kërcime.

Barcelon fiton derbin ndaj Atletico

BARCELONË, 23 PRILL - Nëse do të fitosh titullin, duhet të mundësh skuadra të mëdha. Barcelona po e bën më së miri diçka të tillë, teksa të dielën katalanasit mposhtën minimalisht 1-0 Atletico Madrid duke u afruar edhe

më shumë me suksesin final në La Liga Barcelona u rikthye te fitorja në La Liga, duke marrë një sukses shumë të rëndësishëm, 1-0 në duelin ndaj Atletico Madridit. Dueli i "Camp Nou" u vendos nga goli i

Ferran Torres në fundin e pjesës së parë. Sulmuesi spanjoll do të gjente cepin e portës së Oblak, i cili nuk arriti ta ndalte. Atletico nga ana tjetër do të tentonte në të gjitha mënyrat që të gjente golin e barazimit, por

Ter Stegen do të shpëtonte portën e tij në disa raste. Barcelona administroi rezultatit deri në fund dhe tashmë mbetet në krye me 11 pikë më shumë se Reali, ndërkohë që Atletico mbetet e treta me 60 pikë.





REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLICA OF KOSOVO
 KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
 SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
 SEKRETARIATI - SEKRETARIJAT - SECRETARIAT

Republika e Kosovës
 Republika Kosovo
 SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR I KOSOVËS
 SEKRETARIJAT SUDSKOG SAVETA KOSOVA
 KOSOVO JUDICIAL COUNCIL SECRETARIAT
 Nr. Br. NG. 031574
 24.04.2023
 PRISHTINE - A

Në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ. 1583/20 në rastin nr. KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese datë 09 Korrik 2020, nenit 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullores nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Neni 35 paragrafi 1 pika 1.2 Ligji 06 /L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Udhëzimi Administrativ (Nr. 01/2019) Për Ndarjen e Përgjegjësisë të SKGJK-së dhe të Gjykatave në Çështjet e Personelit, Buxhetit dhe Financave, Logjistikës dhe Prokurimit, Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatën e Apelit (Nr. 06/2021), Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Gjykatat Themelore dhe Degët e Tyre (Nr. 07/2021); Vendimin KGJK.nr.511/2022, te dates 27 dhjetor 2022 (për miratimin e Planit të Përgjithshëm të personelit për gjyqtar dhe administratën gjyqësore për vitin 2023 që përfshinë të gjitha nivelet e gjykatave) dhe Vendimi i KGJK.nr.161/2023 datë 20 prill 2023 ku Autorizohet Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KGJK-së të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për iniciimin e procedurave për shpalljen publike të Konkursit të Jashtëm nr.02/2023, sipas planit të punësimit:

SEKRETARIATI I KESHILLIT GJYQESOR TE KOSOVES
 publikon: **KONKURS I JASHTËM Nr. 02/2023**

Nr.	Gjykata / dega	Posita	Posita të lira	Të rezervuara komuniteti serb
1	Gjykata Komerciale	Zyrtar ligjor	13	
2	Gjykata Themelore Prishtinë	Zyrtar ligjor	3	
3	Gjykata Themelore Prishtinë - dega Podujevë	Zyrtar ligjor	1	
4	Gjykata Themelore Prishtinë - dega Lipjan	Zyrtar ligjor	1	
5	Gjykata Themelore Prishtinë - dega Glogoc	Zyrtar ligjor	1	
6	Gjykata Themelore Prishtinë - dega Graçanicë	Zyrtar ligjor	1	Komuniteti serb
7	Gjykata Themelore Prishtinë - dega Fushë Kosovë	Zyrtar ligjor	4	
8	Gjykata Themelore Prizren	Zyrtar ligjor	3	
9	Gjykata Themelore Prizren - dega Suharekë	Zyrtar ligjor	1	
10	Gjykata Themelore Gjiilan	Zyrtar ligjor	3	
11	Gjykata Themelore Ferizaj	Zyrtar ligjor	2	
12	Gjykata Themelore Pejë	Zyrtar ligjor	5	
13	Gjykata Themelore Gjakovë	Zyrtar ligjor	3	
14	Gjykata Themelore Mitrovicë	Zyrtar ligjor	6	
15	Gjykata Themelore Mitrovicë - dega Vushtri	Zyrtar ligjor	6	
16	Gjykata Themelore Prizren	Zyrtar për përkthim shqip - turqisht dhe anasjelltas	1	
TOTALI I POZITAVE TË PUBLIKUARA			54	

Përshkrimi i detyrave të punës

Posita: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15;

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar ligjor;

Institucioni: Gjykata Komerciale: - 13 (trembëdhjetë) pozita; Gjykata Themelore Prishtinë: - 3 (tri) pozita; Gjykata Themelore Prishtinë - dega Podujevë - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Prishtinë - dega Lipjan - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Prishtinë - dega Glogoc - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Prishtinë - dega Graçanicë (komuniteti serb) - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Prishtinë - dega Fushë Kosovë - 4 (katër) pozita; Gjykata Themelore Prizren: 3 (tri) pozita; Gjykata Themelore Prizren - dega Suharekë - 1 (një) pozitë; Gjykata Themelore Gjiilan: - 3 (tri) pozita; Gjykata Themelore Ferizaj: 2 (dy) pozita; Gjykata Themelore Pejë: - 5 (pesë) pozita; Gjykata Themelore Gjakovë: - 3 (tri) pozita; Gjykata Themelore Mitrovicë: 6 (gjashtë) pozita; Gjykata Themelore Mitrovicë - dega Vushtri: 6 (gjashtë) pozita;

Kategoria Funktionale: Profesional 2;
Grada e Vendit të Punës:/ Koeficienti: Grupi: J; Klasa: J16; Koeficienti: 5.3;
Lloji i Vendit të Punës: pa afat të caktuar, me orar të plotë
Departamenti/Divizioni/Njësia: Zyra për Mbështetje Juridike në Gjykatë / zyra e Ndihmës administratorit në degë
Raporton tek: i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Zyrës dhe gjyqtarin me të cilin punon në Gjykatë / gjyqtarin me të cilin punon dhe Gjyqtarit Mbikëqyrës në degë
Vlerësimi i performancës: nga Udhëheqësi i Zyrës në koordinim me gjyqtarin me të cilin punon/ gjyqtarin me të cilin punon dhe Gjyqtarin Mbikëqyrës në degë
Vendndodhja: Gjykatë /degë përkatëse
Procedura e aplikimit: Konkurs i Jashtëm
Kohëzgjatja e emërimit: Pa Afat - përfshi periudhën provuese 1 vit
Arsyeja e rekrutimit: plotësim i pozitave të lira sipas organogramit

Qëllimi i vendit të punës: (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)
 Kryen të gjitha punët që kanë të bëjnë me shërbimet rreth lëndëve dhe administrimit të tyre në SMIL sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.

Detyrat Kryesore: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të rënditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Mban procesverbalin gjatë seancave gjyqësore dhe ngarkon procesverbalin e seancës gjyqësore në SMIL, si dhe delegon lëndën tek gjyqtari për marrjen e vendimit;.....20%
- Kryen të gjitha veprimet e kërkuara me sistem për të ftuar palët në seancën gjyqësore dhe cakton orarin për mbajtjen e seancës gjyqësore sipas udhëzimeve të gjyqtarit;.....20%
- Për rastet kur kërkohet të bëhet shpërndarja urgjente e shkresave të lëndës, përgatit shkresat dhe kryen veprimet me SMIL për shpërndarje, dorëzim dhe pranim të rezultatit të shpërndarjes;.....10%
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e aktit normativ të është sa më e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik;.....10%
- Përgjegjës për udhëheqjen e punëve të sekretarisë dhe për ofrim të punës cilësore;.....10 %
- Shtyp të gjitha vendimet dhe shkresat tjera të gjykatës, përgatit dhe organizon protokollin nga seancat;.....10%
- Kryen veprime të tjera në SMIL, varësisht nga detyrat e deleguara nga gjyqtari përkatës, si dhe veprimet e tjera të përcaktuara me rregulloret të cilat janë në zbatim;.....10 %
- Kryen edhe detyra tjetër në sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi dhe përgatit raportet javore të punës;.....10%

Përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës: (cilat pozita i raportojnë kësaj pozite dhe cilave pozita ju bënë vlerësim performance kjo pozitë, nëse ka)

Niveli i përgjegjësisë financiare: (p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)

Shkathësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri dhe përvojë në fushën që ndërlidhen me punën e gjyqësorit;.....E nevojshme;
- Njohuri të thellë profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve ligjore;.....E nevojshme;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;.....E nevojshme;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel);.....E nevojshme;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë: Fakulteti juridik;.....E nevojshme;
- Së paku një (1) vit përvojë pune;.....E nevojshme;

Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka: (p.sh. rreziqet e jashtëzakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose rreziqet nga ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve që paraqesin rrezik dhe të cilat rezultojnë nga natyra e vendit të punës ose vendndodhja e vendit të punës)

- Nuk ka

Posita: 16;

Titulli i pozitës së punës: Zyrtar për përkthime (Shqip - Turqisht dhe anasjelltas);

Institucioni: Gjykata Themelore Prizren: - 1 (një) pozitë;

Kategoria Funktionale: Profesional 2;
Grada e Vendit të Punës:/ Koeficienti: Grupi: J; Klasa: J16; Koeficienti: 5.3;
Lloji i Vendit të Punës: pa afat të caktuar, me orar të plotë
Departamenti/Divizioni/Njësia: Zyra për Mbështetje Juridike në Gjykatë / zyra e Ndihmës administratorit në degë
Raporton tek: i përgjigjet dhe i raporton Udhëheqësit të Zyrës në Gjykatë / Krey i njësisë ligjore/ ndihmës administratorit në degë
Vlerësimi i performancës: nga Udhëheqësit të Zyrës në Gjykatë / Krey i njësisë ligjore/ ndihmës administratorit në degë
Vendndodhja: Gjykatë/degë përkatëse
Procedura e aplikimit: Konkurs i Jashtëm
Kohëzgjatja e emërimit: Pa Afat - përfshi periudhën provuese 1 vit
Arsyeja e rekrutimit: plotësim i pozitave të lira sipas organogramit

Qëllimi i vendit të punës: (përshkrim i shkurtër i qëllimit të pozitës dhe çka duhet të arrijë kjo pozitë)

Përkthen materialet simultan dhe me shkrim, duke siguruar një shkallë të lartë të cilësisë në gjuhët e përdorura gjatë përkthimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe akteve normative të miratuara nga Këshilli.

Detyrat Kryesore: (përshkrim i shkurtër i detyrave kryesore, të rënditura për nga rëndësia dhe një përshkrim të përqindjes së kohës, e cila duhet të shpenzohet për secilën detyrë)

- Ofron përkthime dhe interpretime gjuhësore për palët në procedurë gjatë seancave gjyqësore, gjatë takimeve të ndryshme, intervistave, konferencave, etj;.....20%
- Bën përkthimin e të gjitha materialeve (shkresave të lëndës, dekretive, rregulloreve, ligjeve, komentareve të aplikueshme në Kosovë, korrespondencë gjyqësore zyrtare dhe shkresave tjera sipas nevojës së gjykatës) simultan dhe me shkrim20%
- Bën përkthim/interpretimin simultan në seanca gjyqësore, takimet zyrtare, konferenca, seminare e të ngjashme;.....10%
- Bën përkthimin me shkrim të materialeve dhe dokumenteve si: broshurat, raportet e mediave, komunikatat për shtyp;.....10%
- Ndihmon në përcaktimin dhe harmonizimin e terminologjisë, për shkresat dhe dokumentet e përkthyer si dhe saktësinë e tyre me kuptim , gramatikës dhe sintaksës;.....10 %
- Përkthen të gjitha vendimet gjyqësore, parashtrës tjera të administratës gjyqësore, procesverbalit dhe secilin material që i kërkohet nga personat kompetent;.....10%
- Përkujdeset dhe përkthen me shkrim dhe simultan në mbledhje dhe në seanca gjyqësore;.....10 %
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme nga mbikëqyrësi dhe përgatit raportet javore të punës;.....10%

Përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të performancës: (cilat pozita i raportojnë kësaj pozite dhe cilave pozita ju bënë vlerësim performance kjo pozitë, nëse ka)

Niveli i përgjegjësisë financiare: (p.sh. buxheti për të cilin është përgjegjëse pozita përkatëse, niveli i autorizimit për shpenzime)

Shkathësitë e kërkuara: (aftësitë dhe shkathësitë që kërkohen për këtë vend pune)

- Njohuri dhe përvojë në fushën që ndërlidhen me punën e gjyqësorit;.....E nevojshme;
- Njohuri të thellë profesionale në fushën e legjislacionit dhe akteve normative;.....E nevojshme;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;.....E nevojshme;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel);.....E nevojshme;

Kualifikimet arsimore, profesionale dhe përvoja e punës: (kualifikimet dhe përvoja që kërkohen për këtë vend pune)

- Diplomë universitare të vlefshme në Kosovë;.....E nevojshme;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune;.....E nevojshme;

16. Karakteristikat e pazakonta të mjedisit të punës nëse ka: (p.sh. rreziqet e jashtëzakonshme në vendin e punës, presionet fizike ose rreziqet nga ekspozimi ndaj substancave të rrezikshme ose përdorimi i pajisjeve që paraqesin rrezik dhe të cilat rezultojnë nga natyra e vendit të punës ose vendndodhja e vendit të punës)

- Nuk ka

VËREJTJE:

- Procedura e konkursit është hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi Shërbimin Civil Nr.03/L-149 dhe Rregulloren, Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Shërbimit Civil.
- Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qëndrore dhe lokale, si specifikohet në Nenin 11, par.3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
- Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
- Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qëndrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.
- Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare.

• Konkursi është publikuar më datë: 24.04.2023 deri me 08.05.2023

APLIKACIONI:

- Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm;
- Aplikacionit duhet bashkangjitur kopjen e kualifikimeve arsimore të kërkuara sipas konkursit;
- Aplikacionit duhet bashkangjitur kopjen e kontratës së punës dhe dëshmitë të punës;
- Çertifikatën mbi dënimet penale;
- Specializimet e ndryshme profesionale
- Certifikata e përvojës së punës, certifikata të tjera, vërtetime, dy rekomandime etj.
- Kopjen e letërnjoftimit;


VËREJTJE: Nëse aplikacionit nuk ia keni bashkëngjitur dokumentet e kërkuara më lartë dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.

MENYRA E APLIKIMIT:

- Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni pranë Zyreve të Personelit në Gjykatat / Institucionin ku janë publikuar pozitat e lira;
- Aplikacionet e dorëzuara pas përfundimit të afatit të konkurimit nuk pranohen;
- Aplikacionet mund t'i shkarkoni në mënyrë elektronike në Ueb portalin e KGJK: www.gjyqesori-rks.org.
- Fotokopjet e dokumenteve të bashkangjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë t'i tërheqin prapa.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDESKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI – SEKRETARIJAT – SECRETARIAT

Na osnovu presude br. AGJ Ref. 1583/20 u predmetu br. KO203/19 Ustavnog suda od 09.07.2020.godine, član 11. stav 1. i član 18. Zakona br. 03/L-149 Za Civilnu Službu Republike Kosovo, Pravilnik br. 02/2010 za postupak zapošljavanja u državnoj službi, član 35 stav 1 tačka 1.2 Zakon 06 /L-055 o Sudskom savetu Kosova, Administrativno uputstvo (br. 01/2019) o podeli odgovornosti SSSK i sudova po pitanju osoblja, budžeta, finansija, logistike, nabavke, Pravilnik o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u Apelacionom sudu (br. 06/2021), Pravilnik o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u Privrednom sudu (br. 07/2022), Pravilnik o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u osnovnim sudovima i njihovim ograncima (br. 07/2021); Odluka SSK.br.511/2022 od 27. decembra 2022. godine (o usvajanju opšteg plana osoblja za sudije i sudsku upravu za 2023. godinu, koji obuhvata sve nivoe sudova) i Odluka SSJ.br. 161/2023, 20. april 2023. godine, gde je generalni direktor Sekretarijata SSK-a ovlašćen da preduzme sve neophodne radnje za pokretanje postupka javnog objavljivanja spoljašnjeg konkursa broj 02/2023, na osnovu plana o zapošljavanju:

SEKRETARIJAT SUDESKOG SAVETA KOSOVA
objavljuje: SPOLJAŠNJI KONKURS Br. 02/2023

Nr.	Gjykata / dega	pozicija	Broj pozicija	Rezervisani za srpsku zajednicu
1	Privredni sud	Pravni službenik	13	
2	Osnovni sud - Priština	Pravni službenik	3	
3	Osnovni sud - Priština - Ogranak Podujevo	Pravni službenik	1	
4	Osnovni sud - Priština - Ogranak Ljiljan	Pravni službenik	1	
5	Osnovni sud - Priština - Ogranak Glogovac	Pravni službenik	1	
6	Osnovni sud - Priština - Ogranak Gracanic	Pravni službenik	1	srpsku zajednicu
7	Osnovni sud - Priština - Ogranak Kosovo Polje	Pravni službenik	4	
8	Osnovni sud Prizren	Pravni službenik	3	
9	Osnovni sud Prizren - Ogranak Suva Reka	Pravni službenik	1	
10	Osnovni sud Gnjilane	Pravni službenik	3	
11	Osnovni sud Uroševac	Pravni službenik	2	
12	Osnovni sud Peć	Pravni službenik	5	
13	Osnovni sud Đakovica	Pravni službenik	3	
14	Osnovni sud Mitrovica	Pravni službenik	6	
15	Osnovni sud Mitrovica - Ogranak Vucitern	Pravni službenik	6	
16	Osnovni sud Prizren	Službenik za prevode sa albanskog na turski i obrnuto	1	
UKUPNI BROJ OBJAVLJENIH POZICIJA			54	0

Opis radnih dužnosti

Pozicija: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 i 15;

Naziv radnog mesta: Pravni službenik;

Institucija: Privredni sud: - 13 (trinaest) pozicija; Osnovni sud Priština: - 3 (tri) pozicija; Osnovni sud Priština – ogranak Podujevo - 1 (jedna) pozicija; Osnovni sud Priština – ogranak Ljiljan - 1 (jedna) pozicija; Osnovni sud Priština – ogranak Glogoc - 1 (jedna) pozicija; Osnovni sud Priština – ogranak Gracanic (srpsku zajednicu) - 1 (jedna) pozicija; Osnovni sud Priština – ogranak Kosovo Polje - 4 (četiri) pozicija; Osnovni sud Prizren: 3 (tri) pozicija; Osnovni sud Prizren - Ogranak Suva Reka - 1 (jedna) pozicija; Osnovni sud Gnjiljan: 3 (tri) pozicija; Osnovni sud Uroševac: 2 (dve) pozicija; Osnovni sud Peć: - 5 (pet) pozicija; Osnovni sud Đakovica: - 3 (tri) pozicija; Osnovni sud Mitrovica: 6 (šest) pozicija; Osnovni sud Mitrovica - Ogranak Vucitern: 6 (šest) pozicija;

Funkcionalna kategorija: Profesional 2;

Stepen radnog mesta:/ Koeficijent: Grupa: J; Razred: J16; Koeficijent: 5.3;

Vrsta radnog mesta: Na neodređeno vreme, sa punim radnim vremenom

Departman/Odsek/Jedinica: Kancelarija za pravnu podršku u Sudu / kancelarija pomoćnika

administratora u ogranaku

Izveštava: odgovora i podnosi izveštaj rukovodiocu kancelarije i sudiji sa kojim radi u sudu / sudiji sa kojim radi i nadzornom sudiji u ogranaku.

Ocenjivanje radnog učinka: od strane rukovodioca kancelarije u koordinaciji sa sudijom sa kojim radi/sudijom sa kojim radi i nadzornim sudijom u ogranaku

Mesto: dotični sud

Postupak apliciranja: Spoljašnji konkurs

Trajanje imenovanja: Bez roka – uključujući probni period od 1. godine

Razlog regrutacije: popunjavanje slobodnih mesta na osnovu organizacione šeme

Cilj radnog mesta: (kratak opis svrhe pozicije i šta ova pozicija treba da postigne)

Obavlja sve poslove koji se odnose na usluge u vezi sa predmetima i njihovom upravljanjem u ISUP u skladu sa važećim zakonodavstvom i normativnim aktima usvojenim od strane Saveta.

Glavne dužnosti: (kratak opis glavnih dužnosti raspoređeno po važnosti i opis procenta vremena koje treba potrošiti na svaku dužnost)

- Vodi zapisnik tokom sudskih ročišta i učitava zapisnik sa ročišta u ISUP, kao i delegira predmet sudiji na odlučivanje;.....20%
- Vrši sve radnje koje sistem zahteva za pozivanje stranaka na ročište i određuje raspored sudskog ročišta prema uputstvima sudije;.....20%
- U slučajevima kada je potrebno izvršiti hitnu raspodelu predmeta, pripremiti spise i izvršiti radnje sa ISUP-om zaraspodelu, dostavljanje i prijem rezultata raspodele.....10%
- Osigurava da sadržaj i forma normativnog akta bude što je moguće tačniji, kao u jezičkom tako i u tehničkom smislu;.....10%
- Odgovoran za vođenje rada sekretarijata i za obezbeđivanje kvalitetnog rada;.....10%
- Štampa sve odluke i druge sudske spise, priprema i organizuje protokol sa ročišta.....10%.
- Obavlja i druge radnje u ISUP-u, u zavisnosti od zadataka koje poveri dotični sudija, kao i druge radnje definisane pravilnikom koji su u sprovođenju;.....10%

- Obavlja i druge poslove u skladu sa važećim zakonodavstvom i normativnim aktima usvojenim od strane Saveta koje može opravdano zahtevati rukovodilac i priprema nedeljne izveštaje o radu.....10%

Odgovornosti o nadzoru i ocenjivanju radnog učinka: (koje pozicije odgovaraju ovoj poziciji i kojim pozicijama obavlja ocenjivanje radnog učinka ova pozicija, ako ima)

Nivo finansijske odgovornosti: (npr. budžet za koju je odgovorna dotična pozicija, nivo ovlašćenja za rashode)

Potrebne veštine: (potrebne veštine i sposobnosti za ovo radno vreme)

- Znanje i iskustvo u oblasti u vezi sa radom dstva.....Potrebno;
- Detaljno stručno znanje u oblasti zakonodavstva i zakonskih akataPotrebno;
- Stručnosti u komunikaciji i planiranju rada.....Potrebno;
- Kompjuterske veštine aplikacija programa (Word, Excel,).....Potrebno;

15. Obrazovne i stručne kvalifikacije i radno iskustvo: (potrebna kvalifikacija i iskustvo za ovo radno mesto)

- Važeća univerzitetska diploma na Kosovu: Pravni fakultetPotrebno;
- Najmanje jednu godinu (1) radnog iskustva.....Potrebno;

16. Neobičajene karakteristike radne sredine ako postoje: (npr. ekstremne opasnosti na radnom mestu, fizički pritisak ili opasnosti od izlaganja opasnim materijama ili upotrebe opasne opreme koje proizilaze iz prirode radnog mesta ili lokacije radnog mesta).

- Nema

Pozicija: 16;

Naziv radnog mesta: Službenik za prevode (Aalbanskog na Turski i obrnuto);

Institucija: Osnovni sud Prizren: - 1 (jedna) pozicija;

Funkcionalna kategorija: Profesional 2;

Stepen radnog mesta:/ Koeficijent: Grupa: J; Razred: J16; Koeficijent: 5.3;

Vrsta radnog mesta: Na neodređeno vreme, sa punim radnim vremenom

Departman /Odsek/Jedinica: Kancelarija za pravnu podršku u sudu /kancelarija pomoćnika

administratora u ogranaku

Izveštava: odgovara i izveštava rukovodiocu kancelarije u sudu/pomoćniku administratora u ogranaku

Ocenjivanje radnog učinka: Rukovodilac Kancelarije za pravnu podršku u sudu/ pomoćnik administratora u ogranaku

Lokacija: Dotični sud/ogranak

Procedura prijavlivanja: Spoljni konkurs

Trajanje imenovanja: Neograničeno – uključujući probni period od godinu dana

Razlog regrutacije: popunjavanje slobodnih pozicija prema organogramu

Cilj radnog mesta: (kratak opis svrhe pozicije i šta ova pozicija treba da postigne)

Prevodi simultano i pisane materijale, obezbeđujući visok stepen kvaliteta na jezicima koji se koriste tokom prevođenja, u skladu sa važećim zakonodavstvom i normativnim aktima koje su usvojene od strane Savet.

Glavne dužnosti: (kratak opis glavnih dužnosti, raspoređene po važnosti i opis procenta vremena koje treba provesti na svaku dužnost)

- Pruža prevode i tumačenje za stranke u postupku tokom sudskih ročišta, tokom raznih sastanaka, intervjua, konferencija, itd.;20%
- Obavlja prevod svih materijala (spisa predmeta, dekreta, pravilnika, zakona, komentara koji se primenjuju na Kosovu, službene sudske prepiske i druge dopise po potrebi suda) simultano (usmeno) i pismeno;..... 20%
- Obavlja simultano prevođenje/tumačenje na sudskim ročištima, službenim sastancima, konferencijama, seminarima i slično;.....10%
- Obavlja pismeni prevod materijala i dokumenata kao što su: brošure, medijski izveštaji, saopštenja za javnost ;10%
- Pomaže u definisanju i usklađivanju terminologije, za dopise i za prevedene dokumente, kao i njihov tačan značaj, gramatiku i sintaksu;.....10%
- Prevodi sve sudske odluke, druge podneske sudske uprave, zapisnike i sav materijal koji se zahteva od nadležnih lica;.....10%
- Stara se oko pismenog prevoda i prevodi simultano na sastancima i sudskim ročištima;.....10%
- Obavlja druge dužnosti u skladu sa zakonima i pravilnicima, koje se mogu razumno zahtevati od strane rukovodioca i priprema nedeljne izveštaje o radu;.....10%

Odgovornosti o nadzoru i ocenjivanju radnog učinka: (koje pozicije odgovaraju ovoj poziciji i kojim pozicijama obavlja ocenjivanje radnog učinka ova pozicija, ako ima)

- Nema

Nivo finansijske odgovornosti: (npr. budžet za koju je odgovorna dotična pozicija, nivo ovlašćenja za rashode)

- Nema

Potrebne veštine: (potrebne veštine i sposobnosti za ovo radno mesto)

- Znanje i iskustvo iz oblasti vezane sa radom sudstva..... Potrebno;
- Duboko stručno znanje iz oblasti zakonodavstva i normativnih akataPotrebno;
- Veštine u komunikaciji i planiranju rada Potrebno;
- Poznavanje rada na računaru softverskih aplikacija (Word, Excel,).....Potrebno;

Obrazovne i stručne kvalifikacije i radno iskustvo: (potrebna kvalifikacija i iskustvo za ovo radno mesto)

- Važeća univerzitetska diploma na Kosovu:..... Potrebno;
- Najmanje dve (2) godine radnog iskustva Potrebno;

16. Neobičajene karakteristike radne sredine ako postoje: (npr. ekstremne opasnosti na radnom mestu, fizički pritisak ili opasnosti od izlaganja opasnim materijama ili upotrebe opasne opreme koje proizilaze iz prirode radnog mesta ili lokacije radnog mesta).

- Nema

NAPOMENA:

- Postupak konkursa otvoren je za spoljne kandidate i postojeće civilne službenike.
- Postupak regrutovanja se sprovodi u skladu sa postupcima predviđenim u Zakonu o civilnoj službi br. 03/L-149 i Pravilniku br. 02/2010 o postupcima zapošljavanja u civilnoj službi.
- Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Kosova i pozdravlja prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu. Nevećinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima civilne službe centralne i lokalne javne uprave, kako je navedeno u članu 11. stav 3. Zakona br. 03/L-149 o civilnoj službi Kosova.
- Pravo na konkurisanje imaju svi stanovnici Kosova od 18-64.godine

- Konkurs je objavljen od : 24.04.2023. god. i zatvara se 08.05.2023. god.

PRIJAVA:

- Prijava treba da se popuni jasno i čitljivo;
- Uz prijavu se mora priložiti kopija obrazovne kvalifikacije koja se zahteva konkursom;
- Uz prijavu treba priložiti kopiju ugovora o radu i dokaz o zaposlenju;
- Uverenje o krivičnim osudama;
- razne profesionalne specijalizacije;
- Uverenje o radnom iskustvu, ostale certifikate, potvrde, dve preporuke itd.
- kopija lične karte;

NAPOMENA: Ako prijavi ne priložite potrebna dokumenta i ne popunite je tačnim podacima, izgubićete mogućnost ulaska u uži izbor.

NAČIN PRIJAVLJIVANJA:

- Prijave možete preuzeti i podneti u kancelarijama za osoblje u sudovima/ institucijama gde su objavili slobodna mesta;
- Prijave koje se dostavljaju nakon isteka roka neće biti primljene;
- Prijave možete preuzeti elektronskim putem iz web portala SSK-a: www.gjyqesori-rks.org .
- Kandidati nemaju pravo da dobiju natrag fotokopije njihovih priloženih dokumenata.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues